

INTERVISTË ME HALIM HYSENIN

Prishtinë | Data: 24 tetor, 2024

Kohëzgjatja: 168 minuta

Të pranishëm:

- Halim Hyseni (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuese)
- Adea Batusha (Intervistuese)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Halim a mundeni me u prezantu edhe me na tregu diçka për prejardhjen e ju? Familjen? Kujtimet e para?

Halim Hyseni: Po, me kënaqësi. S'pari dua t'ju falënderoj për interesimin e ju, jo për mua po për gjendjen në arsim. Uroj që ne të punojmë bashkarisht të gjithë ta kuptojmë se e ardhmja kryesisht varet nga cilësia e sistemit të edukimit dhe të arsimit. Unë jam punëtor shumëvjeçar i arsimit. Kam lind, siç ju thashë, me 12 qershor 1944 në fshatin Kapit komuna e Medvegjës. Shkollimin komplet e kom përfunduar në gjuhën serbe, duke përjashtuar shkollën e mesme, Shkollën Normale Milladin Popoviç në Prishtinë.

Për herë të parë jom përballë me alfabetin në gjuhën e shkrimit shqip në vitin 1959 kur kom ardhë në Prishtinë për regjistrim. Se në Medvegjë e kom kry shkollën fillore që ka qenë tetë vjeçare. Kam qenë një ndër nxënës të mirë edhe nga serbët edhe nga shqiptarët. Do të thotë kom qenë nxanës i shkëlqyeshëm. Kshtuqë nxanës të atë kohë nxanës të Shkollës Normale mund të regjistroheshin që janë të shkëlqyeshëm pa provim pranues. Për mu ishte shumë e mirë kjo sepse në provim pranues duhej futur gjuhën shqipe. Unë nuk dija asnjë shkronjë, s'e dija asnjë fjalë. Shqip flisja po nuk dija të shkruaj shqip.

Jom fut në kuadër... ka qenë kusht atëherë që në provim të gjithë të futen për aftësinë muzikore, inteligjencën muzikore, a kanë prirje a po jo, se osht' me rëndësi edukimi muzikor për edukim të fëmijëve dhe për atraktivitetin e procesit të nxanit është shumë me randësi dhe ky aspekt i shkathtësive. Natyrisht e kam kry Shkollën Normale. Pas Shkollës Normale unë jam kthyer në fshatin tim dhe kom punuar dy vite. Në fshatin tim deri në vitin 19... 1877 s'ka pasë serb. Po 1877-ten ni pjesë e serbëve nga Peja kanë ardhë dhe nja dy familje janë vendosë në fshatin Kapit.

Por ata shkolla në fshatin Kapit si paralele e ndarë e shkollës në Medvegjë... të gjithë nxënës të kanë qenë shqiptarë edhe të gjithë mësimdhanësit. Prej '48-tes kur u hapë shkolla në Kapit deri në 1964 mësimi është zhvillu në gjuhën serbo kroate. Në vitin e parë të shkollimit unë kom zhvillu mësim në gjuhën serbo kroate me të gjithë nxënës shqiptar. Por duhej çdo mëngjes fëmijëve shqiptar Dobro

Jutro t'ju them dhe ata t'ma kthejnë. Ata s'dinin asnjë fjalë serbisht. Në atë gjendje deri aty të gjithë edhe mësuesit edhe nxënësit kanë qenë shqiptar.

Anita Susuri: Edhe mësuesit?

Halim Hyseni: Edhe mësuesit shqiptar kanë qenë, të gjithë. Unë u ndala dhe mendova që vitin e ardhshëm ta filloj mësimin në gjuhën shqipe. Ishte koha e Rankoviçit. Shumë e randë. E dyta, kishte edhe shqiptar të cilët ishin të indoktrinun, jo kombëtarisht po nuk po flasim për kombin po flasim për njeriun. Bonin shumë pengesa. Po ma n'fund arrita që unë ta hapi shkollën, mësimin në gjuhën shqipe. Shkronjat i kam zhvilluar... ka qenë paralele në gjuhën dhe nuk e di, sot satelitor i qujnë, po paralele, e pa ndarë. Paralele e pa ndarë janë shkollat ku të gjitha klasët mësojnë bashkarisht. Prej klasës së parë deri në klasën e katërt i kom zhvillu shkronjat në gjuhën shqipe.

Kom frikë që m'kapën emocionet. Koha ma e mirë... shihja kënaqësinë në fytyrat e nxënësve. Lumturinë e tyre. Filloj mësimi në gjuhën shqipe edhe sot zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe. Por me dy nxanës dhe me një profesor, i cili është i afërm i imi, i cili jeton atje natyrisht por që ka për auto mekanik. Nuk zhvillohen as tekste, s'kanë as tekste. Osht' punë, punë, puna jashtëzakonisht keq. Pasi punova një vit... unë ndërkohë u regjistrova në Fakultetin Filozofik Dega e Pedagogjisë.

Anita Susuri: Në Prishtinë?

Halim Hyseni: Në Prishtinë.

Anita Susuri: Deshta edhe diçka para se me folë për Prishtinë. A ka qenë problematike ju që keni zhvillu në gjuhën shqipe? A ka pasë ndonjë vrejtje prej policisë ose...?

Halim Hyseni: Jo, jo. Nuk kom pasë vrejtje. Sepse ma merr menja se kom qenë bindës, zakonisht. Unë paraqes argumente se fakti flet shumë më shumë. Kom bisedu me ta. "Bini në pozitën time. Unë e kam kry mësimin në gjuhën shqipe, mësues për të dhënë mësim në gjuhën shqipe jo në gjuhët e tjera. Prandaj unë nuk jam i kualifikuar për mësim në gjuhën serbe". Ata ishin në pozicion t'palakmueshëm. Nuk mund t'më kundërshtonin me fakte. Por ni pasojë e kom pasë tjetër se kur osht' dashtë të shkoj ushtar mu m'kanë çu ushtar në garnizonën e njerëzve problematik në Kërçovë.

Do të thotë i vetmi dënim që e kom pasë nga ajo... se kta mbajnë evidencat për secilin njeri. E kanë kartoteken e bërë për secilin njeri. Unë jam i bindur që qaq pedant janë saqë edhe për ju i kanë sot. E kom regjistru pedagogjinë. Kom punu edhe kom punu edhe kom studiu. Objektivisht t'ju them ni t'vërtetë. M'ka mbetë peng ni gja. M'ka mbetë peng që e kom kry, s'kom shku të studioj landën të cilën unë e kom dashtë dhe për të cilën kom pasë shumë sukses, matematikën. E di që ka qenë një far' pedagogu... ma keni dhanë mundësinë me u shpallu problemi ju' osht' jo i jemi.

Anita Susuri: Po, po.

Halim Hyseni: Manuelo quhej. Na jep fletore e hartimit me shkrim, i shpjegonte, i dha detyrat, i shpjegonte detyrat. Unë ndërkohë i përfundova të gjitha detyrat. Po shkoj po e dorëzoj atë fletoren e matematikës. Po thotë, “Po çka ndodhi me ty?” Thashë, “E kom përfund”. Tha, “S’osht’ e mundur”. “E kom përfund”. Po e merr po e shikon ato të gjitha detyrat mirë. A besoni qita? Lot i kanë dalë. U hutua. S’ka pasë notë pesë plus. Në ditar ma ka vu notën pesë plus. Diçka ma shumë sesa pesshi. M’ka mbetë peng që s’e kom kry matematiken, por nuk jom pendu.

Sepse veç kom dhanë ni kontribut mendoj shumë ma t’madh që e kom kry pedagogjinë, kjo vlen për ty. Sepse pedagogjia, shkenca... unë nuk e quj pedagogji dhe mund të bisedojmë, edukologji. Fjalë në gjuhën shqipe që osht’ s’ka nevojë ma mirë se ta qujmë edukologji do të thotë në vend të pedagogjisë. Kom dhanë kontributin e duhur. A e kom përfund Shkollën Normale? E kom përfund fakultetin mrena katër viteve pastaj jom... kom shku kom punu në Lajthishtë. Lajthishtë është ktu ni fshat Hade, afër Hadës. E qujnë Leshkoshiq. Aty kom punu nja dy vjet. Shpresoj se kom punu mirë. Sepse m’donte mu fshati m’donte shumë, m’respektonte sepse isha i saktë me shku, nuk mungoja.

Sepse vinin njerëzit ktu studionin, punonin edhe tani n’shollë shkonin kur u tekej atyne, i krynin puntë e veta. Unë nuk e boja këtë gjë. Aty kemi pasë shkollë të kombinuar. E para e treta dhe e dyta e katërta. Do të thotë ka qenë dy mësues kanë qenë. Unë dhe ka qenë ni mësues tjetër. Dy vjet edhe e kom kry. Pas dy vjete pasi kreu fakultetin kom shku dhe kom punu në Ferizaj. Jom punësu në Shkollën Normale Zenel Hajdini në Ferizaj. Në Zenel Hajdin kom punu dy vite edhe ato dy vite kom kalu jashtëzakonisht mirë. Nuk e di a osht’ për ta thënë. Por e kom bo ni veprim i cili akoma sot më mundon. Se i kom ngelë në klasë në riprovim shtatë nxënës, mashkuj dhe femra.

Anita Susuri: Ju keni jetu me familjen thatë në Kapit në Medvegje që ka qenë pas Luftës së Dytë Botërore veç pjesë e ndane. Pastaj ju ka ardhë me studiu shqip thatë në Prishtinë. Po du pak nëse mundeni me na tregu edhe për jetën e familjes t’juj n’atë rreth po edhe pastaj ato çka ju e keni pa kur keni ardhë në Kosovë, në Prishtinë?

Halim Hyseni: Kosova ka qenë si dielli që osht’ për tokën për shqiptarët e Maqedonisë, shqiptarët e Malit të Zi dhe shqiptarët e Preshevës e Medvegjës dhe Bujanocit. Unë si nxanës e kom pasë emër edhe mbiemer Hysenoviç. A Prishtina osht’... Kapiti nga Prishtina osht’ 80 kilometra larg. Në provim pranues kur kom ardhë kom ardhë n’kamë.

Anita Susuri: N’kamë.

Halim Hyseni: N’kamë kom ardhë. Lidhjet kanë qenë të tmerrshme. Sigurisht mbi dhjetë herë kom kalue, kom shkue, jom kthy n’kamë nga Prishtina deri në Kapit dhe mrapa. Ne objektivisht jemi... osht’ edhe ni Kapit në Alpet Shqiptare. Në 543-tën kur bohet invadimi i parë serb që vijnë sllavët Përkupi i

Tezaresë është nga Parecina i qun skllavos. Që mos t'del që po e quj unë kshtu, ai i ka qujtë skllavos. Ndërsa Tolemeo... se serbët përmenden për herë të parë në shekullin e dytë nga Tolemeo.

Kur kanë ardhë serbët, sllavët. Sllavët kur kanë ardhë janë shpërngul në fshatrat ma të largëta të mundshme për të shpëtu jetën. Kanë shku edhe kanë emërtu Tupunimi Kapit edhe ai Kapit osht'. Po me ardhjen e turqëve... se turqit e kanë pasë edhe e kanë ni filozofi sikurse që e kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ata i pranojnë të gjithë, s'o me rëndësi. Po në qoftëse dëshmohen ju jepin përparësi të përparojnë edhe të shkojnë në grada. Kanë fitu lirinë e janë kthi në vendlindjen e vet.

Se afër Kapitit nja 29 kilometra osht' ni Bojnik quhet. Krejt ka qenë i banuar me shqiptar. Aty ka lind Jus Njani i parë. Sot osht' ai vend quhet Cariçingrat. Ai ka qenë me prejardhje ilire se atëherë s'ka pasë shqiptarë. Unë e kom kto librat e mia se unë mirrem edhe me histori bukur shumë dhe e njof historinë bukur mirë. Ai Jus Njani thotë, "Unë jam ilir, do t'i mbroj ilirët". Kshtuqë kta janë kthyer në Kapit dhe kanë mbetë prej atëherë dikund në shekullin e 16 janë kthi tantë, t'parët e mi. Ni pjesë e vogël jeton se tjetër janë shpërngul të gjithë.

Në familjen time tash i kom, se ndoshta edhe kjo ju intereson, dy djem. Njo e kom në Austri, punon atje, ka ndërtu shtëpinë edhe i ka puntë jashtëzakonisht mirë. Ka dhanë mësim në UBT. Osht' [problem teknik me mikrofonin] i kësaj Rrotës. Për Rrotën s'e di a e dini? A e dini? Rrota, kjo firma Rrota.

Anita Susuri: Po, po.

Halim Hyseni: Ai osht' pronar, djali jem osht' pronar, hala osht' pronar i saj prej atjehit. E dyta, djali i dytë... ai i pari osht' i madhi Astrit e ka emrin edhe i dyti Petrit. Ka qenë në Londër, ka punu deri tash. Tash për shkak timen edhe të nanës t'vet osht' kthi edhe po punon ktu. Jetojmë bashkë. Domethanë i kam dy djem ktu. Pjesa dërmuese e familjes osht' ose jashtë ose osht' ktu...

Anita Susuri: Në Medvegje ma nuk jeni?

Halim Hyseni: Në Medvegje unë e kam tokën në emër tim e kam përkthi edhe unë e paguaj tatimin. Se kanë marrë ni vendim... do të thotë toka ende osht' në emën tim edhe të vllave të mi. Unë nuk mund të kthehem sepse gjatë luftës mu m'kanë kërku edhe me m'pasë zanë të Arkanit unë sot s'isha me ju. Unë as s'kom vra njeri, as s'kom sulmu njeri.

E kom pasë ni zavendës serb ka qenë, burrë i mirë i jashtëzakonshëm. M'ka nderu shumë. E di kohën e minatorëve kur ishin minatorët ishin në zgafellë ne vendosëm që për ta ta qojmë ni telegram përkrahje. Ai ishte në gjendje të tmerrshme. Nuk dike, s'dinte çfarë të bëje. Unë e pashë që po shqetësohet shumë. Thashë, "Ndëgjo, o' Buçko" - e qujshim na, Ovislav e ka pasë emrin - thashë, "Mos u mërzi fare për këtë punë. Ti ki t'drejtën tane me thanë jo edhe me votu kundër". Kur i kom thanë ai u gëzu jashtëzakonisht shumë, sikur botën me ia dhanë.

T'nesrit ai ka votu kundër po ka qenë ni... ka pasë edhe serb tjerë ku isha unë në pedagogji të Kosovës. Ai ka votu por ka votu për ne, ai osht' largu prej atyhit. Unë s'kam dëgju ma a osht' gjallë a jo po e di që ajo ka qenë femër. Jom interesu, kanë thanë që ajo punon po punon tejte kund. Ni detal i vogël i jetës time. Qikjo osht' rreth familjes time. Ni pjesë ktu i kemi hala.

Anita Susuri: Ju sa fmi keni qenë n'familje?

Halim Hyseni: N'familje kemi qenë baba im, baba im ka qenë ka marrë pjesë në luftë. Me bindje ka qenë sikurse shumica komuniste, ka qenë... Titon e ka dashtë shumë. Po them hapur. E ka mbajtur fotografi që unë përkundrazi unë kur e kom kuptu kush ka qenë e si është jo që e urrej sepse ka qenë edhe kundër nesh edhe pse ne na ka ndihmu '66-ten, po vetëm pse ka qenë ai i rrezikun nga serbët. Se... ju jeni të reja nuk e dini. Brioni osht' mbajtur se s'ka pasë besim me u mbajtur takimi në Beograd se e mysin, kur ka ra Aleksandër Rankoviçi.

Por baba ka qenë n'këtë aspekt ka qenë njeri i mirë, i drejtë. Në kohën e fundit u kthy atdhetar u bo. Ai s'ka qenë veprimtar, ka qenë punëtor. Bujk ka qenë s'u marrë me veprimtari të tjera. Kemi qenë gjithsej dhe jemi katër vllazër. Nja e kam në Zvicërr, ni vlla e kam ktu dhe ni vlla ka vdekë nga COVID. I kemi nipat, e mesat e sene janë ktu. Qikjo kish me qenë rreth familjes time.

Anita Susuri: M'tregut për kohën kur keni ardhë në Prishtinë. Po du me ditë për qat' ndjenjën? Si ka qenë? Na tregut që ka qenë dielli për Kosovën për këto vendet...

Halim Hyseni: Ka qenë dielli, ka qenë dielli. Unë nuk e dija fjalën qytet. E kom dëgju edhe t'u mendu që qytet e kom kuptu si qytek. Ju e dini çka osht' qyteku. Po thom kshtu, ni ironi, "Po dal n'qytek". Ata po qeshin. E dinin që unë s'e dija atë fjalë. "Pse po kërkon qytek ti?" Atëherë e kuptova që s'kom thanë atë që u dashtë me thanë. Ma shpjegun fjalën qytet. Ka qenë periudhë tepër e randë deri në '66-ten sepse po e lexoja Rilindjen me veti. Policia kishte detyrë m'i përcjellë a po lexohet Rilindja. E lexon Rilindjen ai futet n'burg. Isha nxanës i mirë une po isha me grup... në mesin e të tjerëve e kisha mik edhe jaran, gjithë natën kem nejt, Fazli Grajçevcin. Se di a keni dëgju për të apo jo?

Anita Susuri: Po, osht' vra në burg.

Halim Hyseni: E kanë vra në burg. Në rrugën Robert Grajniku ka qenë, ka qenë Zeqir Gërvalla, ka qenë Avdyll Lahu. Ka qenë ni grup i nxënësve me të cilët edhe jemi shoqëru. Po mu m'ka shpëtua dy elemente n'atë periudhë. Isha nxanës i disiplinun dhe isha nxënës i mirë. Nuk kishte ndër ma të mirët. Ka shkru naj kush naj libër dhe m'kishte ngrit në qiell dhe kishte thanë që është nxënësi më i mirë i të gjitha kohërave të Shkollës Normale. S'osht' e vërtetë se s'kom qenë ai, nuk kom qenë ai. Ka qenë dikush tjetër dhe e di personalisht kush ka qenë ai që ka qenë nxënësi më i mirë i Shkollës Normale.

Ajo çka desha të përfundoj rreth Shkollës Normale ishte që ambienti në shkollë ishte i mirë. Ka qenë bukur. Ka qenë puna e profesorëve ishte shumë e mirë. Mu m'ka dhanë mësim ky Hoxha, Lugjet e Verdha, Rexhep Hoxha m'ka dhanë. M'ka dhanë mësim edhe ni... ka punu në bibliotekë. Nuk po m'kujtohen të gjithë se me emra po i harroj. Po si nxënës mu m'ka shpëtu si nxënës i mirë një po edhe fakti i dytë që unë e kam ditë serbishten. Unë hartimet në gjuhën serbe kur i shkruja i merrnin hartimet në gjuhën serbe dhe i shpërndanin. Ky element më ka shpëtu që unë në Shkollë Normale e kam krye me kohë po jo qysh kom qenë në shkollën fillore.

Gjitha të mirat që populli, kombi shqiptar i ktyne trevave që i ka, gjithë përparimi i këtij kombi shqiptar duhet sot Kosovës faleminderit. Por osht' edhe ni e vërtetë që ne të anës së Medvegjës kem dhanë ni kontribut të jashtëzakonshëm për Kosovën. A radha e parë partizane ka qenë me emërtim Zenel Hajdini. Zenel Hajdini ka qenë hero i shpallur në Serbi. Tashti nuk e qujnë Zenel Hajdini po Hajdinoviç. Familjen e tij e përsekuton Serbia. E dyta dy profesor kanë qenë të diplomum në fakultet në vitin 1950. Ka qenë Xixir Bajrami i Medvegjës dhe ka qenë ni Ramadani i Gjilanit. Veç dy profesor kanë qenë të diplomuar.

Kshtuqë në aspektin e arsimit ne të Medvegjës kemi dhanë. Po kemi dhanë edhe doktorin e parë në gjuhën shqipe, Idriz Ajetin. Akademikun Idriz Ajeti. Dhe themeluesi i universitetit të gjuhës shqipe ktu ka qenë Idrizi, ka qenë. Natyrisht që kemi edhe ne edhe të fundit e kemi një në Medvegje ka qenë edhe Jusuf Zejnullahu ky kryeministri i fundit. Që me 5 qershor kur u fut Serbia i largun. More unë po flas shumë, po ju...

Anita Susuri: Neve krejt po na interesojnë.

Halim Hyseni: Folni, pytni, qikjo kishte qenë. Pësja e Kosovës për ne shqiptarët e kto të ktyne trevave të Malit të Zi, të Maqedonisë edhe të Medvegjës Kosova pësja e saj nuk mund të matët. Osht' e jashtëzakonshme.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Kur keni ardhë me jetu, domethonë në Prishtinë, edhe m'tregut për Ferizajin dy vite keni punu po pastaj...

Halim Hyseni: Mirë, t'ju tregoj. Jom shku ushtar. Isha mas dy vjete që isha në Shkollë Normale shkova ushtar. Kur u ktheva prej ushtrisë jom pedagogu i parë që ka qenë në Kosovë në Shkollën Teknike Nikola Teska në Ferizaj. Aty ka qenë xhemajl Kasumi, ni matematikan ka dhanë mësim. Kem ba, kem pasë arritje të jashtëzakonshme bashkë se bashkëpunonim shumë. Aty nuk qëndrova shumë, vetëm ni vit. Pasi kom kalu në entin pedagogjik të Ferizajit. Enti për Përparimin e Edukimit dhe të Arsimit. Ashtu janë qujtë, ente ndërkomunale. Aty kom punu si këshilltar pedagogjik. Kom punu deri në vitin '75.

Në vitin '75 kom ardhë edhe jom punësuar në Entin Rajonal Pedagogjik të Prishtinës. enti për Përparimin e Edukimit dhe të Arsimit në Prishtinë. Kem qenë entusiast jashtëzakonisht shumë. Kem bërë hulumtime. Du t'ju them ni gja, për shembull, ke bo ni hulumtim se çfarë është kriteri i vlerësimit të nxënësve. Ne kemi marrë matematikën. Natyrisht unë kisha prirje për matematikë dhe me ni koleg timin i cili ishte në Shkollë Normale ishte edhe këshilltar në Entin Pedagogjik. Kemi bo testimin e nxënësve të komunës të qytetit dhe të fshatrave.

Nota, pesshja, në landën e matematikës në fshatra ka qenë e barazvlefshme me dyshin. Sepse mësimdhënësit... jo me fajin e mësimdhënësve por kanë qenë mësimdhënës të pa kualifikuar. Juve si pedagog po ju them, studimet në Australi kanë treguar se për suksesin e nxënësve ka numër të madh të faktorëve që përcaktojnë suksesin e ni nxanësi. Po sukseasi varet për 30% i suksesit, arritjes së nxënësit varet ma shumë nga mësuesi sesa të gjithë të tjerët. Do të thotë mësuesi, mësimdhënësi i aftë siguron edhe sikurse që ju e dini aksionet pedagogjike që... në lëvizjet e shkollave efektive. Shkolla efektive quajmë shkolla që prodhojnë ekstra vlerë. Do të thotë prodhojnë ni vlerë shtesë që s'e prodhojnë të tjerat.

Kjo ka fillu vitet e '70-ta edhe sot zgjat. Në shkollat efektive është konstatua se askund në botë nuk kanë gjetë shkollë të suksesshme. Institucion edukativ të suksesshëm me drejtor të dobët. Nuk ka. Por, kjo jo veç për shkolla por kjo vlen edhe për shtetet por edhe për institucionet tjera. Kudo që janë varet nga lideri. Sepse osht' ni terminologji e gabuar te na. E quajmë për shembull drejtorin e shkollave menaxher. Ai nuk duhet t'jetë menaxher.

Menaxher osht' ai që duhej ta kryej punën ma së miri që është e mundshme që e ka përcaktu dikush tjetër, ai osht' menaxher. Atij nuk i intereson a osht' kjo që m'ke thanë ti mu e mirë apo e keqe. M'ke thanë ti mu, qat' punë duhej ta bëj. Detyra jeme osht' vetëm këtë punë me ba, jo tjetër. A drejtori duhet t'jetë lider. Lider do të thotë që ka ndikim. As ma pak as ma shumë vetëm është njeri me ndikim. Ne u dashtë, osht' dashtë që t'i aftësojmë n'këtë periudhë pas luftës që gjithmonë është qajtë periudha e pas luftës, osht' dashtë të merremi me aftësimin e drejtorëve të institucioneve edukativo arsimore. Pse po e themi një të vërtetë? Thasë të eurove janë shpenzuar që janë marrë nga faktori ndërkombëtar që janë derdh në gjepa privat. Sepse agjendët e ndryshimit nuk janë identifiku. Ata që duhen të jenë. Andaj, arsimin e kemi në këtë gjendje çfare osht'.

Pastaj për entin pedagogjik kom shku aty si ushtrues i detyrës së drejtorit. Ka qenë me politikë ka ardhë ni femër tjetër. Nifar' Smila Mihajloviç. Nji episodë. Erdh ajo edhe natyrisht unë e kisha ndikimin t'madhe. Pse? Ku unë punoja i kisha tre profesor t'mi që i kisha të Normales. Driton Qamilin, Nexhat Ibrahim. E kisha edhe Dim Vaçiçin që ka qenë zavendës kur isha unë në Shkollë Normale. Ata ishin n'dorë t'mi. Ajo Smila kur erdh me solucion duhej me qenë serbe. Në të vërtetë edhe përpara ka qenë serb, une si ushtrues detyre tani përsëri erdhi Smila.

Ajo Smila e cila erdhi kishte, ka qenë profesoreshë në gjimnaz, Gjimnazin Sami Frashëri, atëherë quhej Ivo Lola Ribar. Kem pasë ni bashkëpunim shumë të mirë. Por, dy episoda janë kshtu. M'ka thanë ni gja të cilën unë e kam edhe e kam fut në ni aspekt ni pasazh të vogël në libër, ni libër që e kom punu. Ajo thotë, “Unë rranjtë i kam shqiptare se jam prej fisit Piper”. Malabezët ju e dini si shqiptarët i kanë edhe fiset. Në ‘91-shin kur ishte ‘91-shi erdhën do gazetar, i futëm brenda aty edhe fillun. Erdhën me kriju probleme me fillu diferencim. Unë isha atëherë ushtrues i detyrës së drejtorit.

“Mirë se keni ardhë zonja dhe zotërinjë”, ishin gazetar, “Çka osht’? Qysh osht’ puna ktu?” “Ktu serbët kanë pozitë t’mirë e sene”. Unë jam çu, “E kom të qartë çdo gja. Në qoftëse keni ardhë për diferencim, çdo e mirë edhe çdo e keqe në këtë institucion varet nga unë dhe në qoftëse mendoni se ktu osht’ keq, mua duhet të filloni të më diferenconi”. Por unë e kisha ni background kshtu donin edhe serbët edhe shqiptarët. Kshtuqë ata u shpërndan ma nuk e ban problem.

Por disa ditë masanej në ni tualet... m’falni ju të nderuara se ju trajtoj si vazjat e mia, në tualet isha në zyre...se në zyre në tavolinë ishte Smila atje unë n’këtë anë tavolina ime. Ajo është e vrut, e zezë. Ishin, u nxi si e tërbuar. E vrejta. Natyrisht psikologjia m’ka ndihmuar më ndihmon edhe sot. E vrejta që s’osht’ diçka n’rregull. E vrejta, “Smilë, çka ka?” Tha, “Në tualet e kanë shkru KR edhe e kanë vizatu do si çorapave”. A dini çka janë çorapat ju? Ksi që i bojnë gratë. E kanë shkru. Thashë, “E kom të qartë”. Kjo osht’ bo për shkak timin.

Anita Susuri: Cili vit ka qenë ky?

Halim Hyseni: ‘81-shi. Kjo osht’ bo për shkak timin. Meqë është bo për shkak timin unë jom i hapur, s’kam kurfar problemi. Por këtë e kanë shkru serbët. I përmenda emrin. Thashë, “E ka shkru Bobana ajo. Me fshi duhesh ti”. Ka shku e ka fshi. E kem tejkalu ni problem pa kshtu, pa telashe të mdha. Po kjo s’osht’ me rëndësi hiç, s’osht’ me rëndësi. Pastaj unë kam qenë zëvendës tan kohën. Kanë qenë këto periudha tepër të randa. Sepse fillun me i sulmu bustat që kanë emra shqiptar.

Ishte situatë e randë se ka qenë ni këshilltare serbe në mbledhje dhe ishte ajo drejtoresha po ajo m’donte mua shumë. E hapi problemin e bustit, e emërtimit të Hasan Prishtinës. Se nacionalistët i kanë emërtimet me nacionalista se nuk e di a e dini ju. Hasan Prishtina dy herë ka qenë i burgosur dhe ka qenë i burgosur në Beograd, ka qenë i ndjekur. Është një ndër heronjtë dhe njëri nga shumë të mdhejt të kombit tonë. Smila nuk ka folë, ajo far’ drejtoresha.

I kom thanë asaj, “Kolegë, ne as nuk i caktojmë emrat as nuk i heqim emrin. Prandaj, të lutem kurrë ma këtë çashtje mos me hapë ktu sepse kjo nuk osht’ çashtje me të cilën ju duhej të merreni. Ju jeni përgjegjës për të konstatuar cilësinë e edukimit dhe të arsimimit. Folni sa të doni ktu për këtë në qoftëse keni vrejtje por jo për buste”. Natyrisht e kalova. Por ishin... ish ajo periudha kur mu më bonin presion forcat me kalu si drejtor i entit pedagogjik. Ma vonë, ma vonë ishte ajo...

Anita Susuri: E në shkollë, më falni se po ju ndërpres, a ka pasë arrestime të nxanësve? Në shkollën e ju?

Halim Hyseni: Unë s'kom qenë... jo, unë në Ferizaj kom punu para vitit '74-ten. Tani me '74-ten kom ardhë në Prishtinë. Kom punu deri në vitin 1986. Me 1 janar të vitit 1987 jom zgjedh drejtor i Entit Pedagogjik të Kosovës. Është qytë përpara Enti për... Enti i Kosovës për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit në Kosovë. Me 1 janar të vitit 1987... Keq osht' me thanë, nuk du ta krahasoj po kem bo në Komunë të Prishtinës kem ba shumë punë, enti ka bo shumë punë që m'vjen keq që sot s'kemi institucion të tillë.

Ju e dini që e kem Institutin për Studime të Kosovës. Më fal për shprehjet, a më kriton, se unë kshtu kam qenë dhe kshtu do t'vdes por nuk ka ligj për të, nuk ka rezultate. Nuk ka kontribut. A e dini si e kemi këtë Ministrinë e Arsimit kombinat të njerëzve të cilët s'dijnë çka po bajnë edhe pse janë aty. Problemet... por natyrisht për kto unë do t'i kam librin me argumente. Me '87-ten deri... a ka pasë nxanës që janë... po, ka pasë nxanës edhe ju i keni kto librat, qit' librin tim për helmimet ni pjesë. Kemi t'vram, kemi t'plagosur, kemi t'rrahur, kemi t'malltretuar, me emra dhe mbiemra.

Por, në vitin 198... kur ju përmenda këtë Librin e Bardhë du t'ju përmendi edhe ni akt të cilin populli shqiptar duhet ta mbaj mend dhe ta studion. Ju kisha sugjeru bërthamat e përbashkëta programore. Ka qenë projekt serb për shkombtarizimin e të gjithëve. Sepse në librin e bardhë thuhet, thojnë, se Serbia ka humb në formimin e Jugosllavisë. Sepse ka padrejtësi edhe pse populli serb... nuk e di a e dini a jo, dymbëdhjet bashkësi familjare kanë mësu serbisht. Do të thotë krejt, të gjitha republikat edhe dy krahinat serbishtja ka qenë e obliguar. E vetmja landë e obliguar për të gjithë në krejt Jugosllavinë ka qenë.

Këtë unë ju kom thanë me ni sumpozium që është zhvilluar në Llozhnicë, serbëve. Nuk e kanë botu punimin që ju kom thanë. Ju thashë, "Ju po ankoheni por jeni populli me gjuhë ma precizioze në Jugosllavi. Sepse dymbëdhjetë familje etnike e mësojnë gjuhën serbe si gjuhë të obliguar. Askush tjetër. Unë, ju p'e shifni, e flas ma mirë..." Edhe sot e flas ma mirë serbishten se shqipen. Bazën e kom pasë. Për drejtor të entit pedagogjik kur kom shku ka qenë, kundër kandidat e kom pasë nifar' Staveliçi. Ka punu në Bashkësinë e Shkencës. Mahmut Bakalli ka qenë, mbasi e kom lexu, ka qenë këshilltari i tij. Në aspektin politik, lidhjes politike, larg pamësisë ka qenë shumë përpara meje.

Anita Susuri: Mahmut Bakalli?

Halim Hyseni: Staveliçi. A Mahmut Bakalli, për politikë sigurisht po, për ideologjinë që ai e ka njëkë... Ai ka qenë se... ka qenë orator i mirë, ka ditë me folë. Por, ideologjia ekstreme e majt ka qenë e gabuar. Nuk kemi nevojë me folë. Po unë fitova. Forcat... disa forca të cilat ishin të interesuar se gjendja ime në pedagogjik ishte në krizë. Ju keni dëgju për Jusuf Shushkën? Jusufi ka qenë profesor i imi në normale. Alamet profesori i mirë. Osht' e vërtetë që pedagogjinë e ka kry ma vonë, pas meje, pas meje.

E kanë çu në ent pedagogjik e kur ka shku në mbledhje e kanë shti të qan, e kanë detyru të qan dhe e ka lshu mbledhjen dhe ka thanë, “Unë ktu, kama jeme nuk shkel”. Ishte problem me shku në pedagogjik. Ka qenë nifar’ Anton Glazoviçi ka punu në bashkësinë e arsimit me Bajram Shatrin ka punu ni kohë. Ka nejt nja ni muj ditë. Kur e mori vesh që unë do t’shkoj edhe m’takoj mu ai m’tha, “Ku po shkon o Halim? Se me shku në pedagogjik kur më bjen në mend në andërr që jom në pedagogjik, del gjumi edhe bohem si i çmendun. Mos gabo me shku se aty s’ka kush që mund e rregullon”.

Mirëpo ka qenë edhe ni gja se aty ka qenë i koncentrun disa personalitete që kanë vdekë e që nuk du t’i përmedi emrat por që kanë qenë me tituj shkencor. Titulli shkencor ktu në Kosovë kishte fuqinë a magjikja edhe ata bënin çfarë të donin. Unë kur shkova, unë nuk kisha, as sot s’kam titull shkencor. E kam kry në Zagreb me notë t’mirë magjistraturën por për shkak të problemeve që kisha me institucione nuk shkova me mbrojtë temën e magjistraturës. Ashtuqë jom profesor katër vjeçar me degën e pedagogjisë që e kam kry.

Shkova në ent pedagogjik edhe kur shkova në ent pedagogjik, Rexhep Osmanin e kishin përjashtu për shkak të bërthamave të përbashkëta të programuara. Se kishte kundërshtu. Aty me shumë elemente... kangtë në gjuhën shqipe muzikë nuk duhet t’ketë, serbisht duhet t’jenë. Kërkohej që mësimi të zhvillohej dy gjuhësor shqip edhe serbisht brenda orës. Kërkohej që administrata të mbahet në gjuhën serbe edhe n’gjuhën shqipe. Ju e dini ditaret? Në gjuhën serbe. Por unë rrijsha në pedagogjik të komunës, shkruja gazeta. I kom 200-300 punime të publikuara në revista të ndryshme lidhur me këto çashtje.

Ishte situatë e palakmueshme. Qat’ ditë që i kom shkru unë, t’nesrit e kom kthy Rexhep Osmanin n’punë. Jo vetëm që e kom kthy por edhe kom siguru pagesat. Fikri Arifi m’ka thirrë prej Beogradit. M’thotë mu, “Çka ke shkru? A ke shkru me ndreqë a me rrënu punë?” Thashë, “Fikri kjo punë nuk zgjidhet me telefon. Kur të kthehesh unë t’vi në zyre”. Prandaj, ndëgjoni, vajza të reja po ju trajtoj si vajza të mija. Njeriu mund t’jetë edhe i mirë edhe i keq. Por m’besoni, mos i kërkonit t’keqën te njeriu. Por bon përpjekje të kërkonit t’mirë. Qata që kërkon, qata e gjen.

Shkova te Ekremi, me mu Rexhep Osmani erdh te komiteti që osht’ në qendër aty, e dini sigurisht. Thashë, “Ti Rexhep shko pi kafe atje poshtë në byfe, unë e kryj punën knej. Bonu gati që ti edhe unë sot shkojmë n’shpi”. Se situata ishte e tillë. Nuk mund ta merrni me mend çka ka ndodhë. Çfarë gjenocifi osht’ zhvilluar në vitet prej ‘80-tes deri në vitin 1988 në Kosovë. Gjenocid i pastërt në paqe. Prandaj kur e përmenda këtë gjenocidin e pastërt, gjenocid zinxhiror edhe n’luftë edhe në paqe. U zhvillua në paqe.

Bisedova me të edhe i thashë, “Ktu me zbatu shkencë. Planet dhe programet janë të Kosovës dhe ne i hartojmë”. Unë e kam përgadit letrën për Akademinë e Shkencës, me m’i dërgu akademikët e shkencës për hartimin e planeve dhe programeve. E kom informu Kuvendin e Serbisë se mësim dy gjuhësor në

Kosovë nuk mund të organizohet. E kom lajmëru, administrata nuk mund të mbahet. E dyta krejt puntë çka kryhen në Kosovë me fushën e edukimit dhe arsimit osht' përgjegjës në bazë të ligjit dhe kushtetutës së Kosovës Enti Pedagogjik i Kosovës.

M'përiti jashtëzakonisht mirë Arifi dhe unë e çmoj shumë. M'tha, "N'rregull është. Prej ditës së sotit puna e Rexhep Osmanit nuk osht' e jotja osht' e imja". Por m'tha, "Unë e kom pasë gjeneratë, unë e njoh ma mirë sa e njeh ti". Thashë, "Nuk po hi ma tutje por përgjegjësinë për këtë punë nuk du me ta lanë ty. Unë e pranoj se s'e kam ba nga naiviteti se s'jam naiv". Tha, "Ti harro këtë punë, është punë e jemja. Puna e Rexhepit osht' punë e jemja", edhe s'ka pasë problem. Si kom shku, i kom thanë Rexhepit, "Rexhep krejt kto t'mirat që unë po mendon që t'i kom mohu, s'i kom bo punë po i ka bo Ekrem Arifi".

Nejse, ky proces osht' proces tjetër edhe kom fillu punën në pedagogjik. E kemi formu. Qe për shembull po tregoj vetëm ni detal. Kryetari i komisionit për hartimin e planeve të programeve ka qenë Ibrahim Rugova. Anëtar i komisionit ka qenë Rexhep Qosja. Anëtar i komisionit ka qenë ky profesori që, i Vitisë që osht'. Se ky i ka punu edhe përpara, nejse s'o me rëndësi. E kemi hartu planin e veprimt. Nga dita që unë kom shkue jom shumë krenar. Asni dokument Serbia nuk ka mujtë me realizu në Kosovë. Të gjitha janë realizue, me muzikë, me gjeografi, me gjuhë, komplet planet dhe programet janë hartue nga grupet shqiptare.

Jom shumë krenar për këtë punë. Por, nuk osht' kjo veç punë e jemja, osht' punë e të gjithë të tjerët që kanë punu aty. S'osht' meritë e jemja osht' meritë e të tjerëve. Sigurisht që bisedat i kemi zhvillu në Beograd. Drejtën me t'thanë s'jom e knaqun me bisedat që po zhvillohen Kosova me Serbinë.

Anita Susuri: Për momentin?

Halim Hyseni: Për momentin. Nuk jom... gabim osht' që kanë hy n'biseda në radhë të parë. S'më intereson orientimet e juaja politike. Ka t'drejtë ta dini dikund. Unë kurrë asni moment s'kam qenë anëtar i Lidhjes Demokratike. M'kanë zgjedh edhe vota shumë kom marrë. M'kanë zgjedhë në kuvend në Shkollën Gjergj Fishta kom dalë edhe ju kom thanë, "O koleg të nderuar, faleminderit për zgjedhjen që m'keni zgjedhë. Por unë nuk jam anëtar i Lidhjes Demokratike".

Po këtë ia kam thënë Albin Kurtit në 2015-tën. A ju [duke iu drejtuar organizatës] kishit qenë në 2015-ën, e di, e kom lexu historinë e ju. I kom thanë, "Albin", m'ka thirrë Albini m'ka thanë, "Halim, a po vjen anëtar me qenë për deputet?" I kom thanë, "Albin, të nderoj të respektoj. Por, unë nuk punoj për parti. Unë angazhohem për arsimin e Kosovës, jo për arsimin e partive politike". Ka pasë mirëkuptim, s'kom qare pa e thanë. Ka pasë mirëkuptim. Ka thanë, "Faleminderit profesor, në rregull oshtë". Edhe ni herë e kom taku, kurrë s'e kom pa ma tutje. E përmenda këtë rast se situata ishte tepër e randë. Gabun pa shku unë, patën gabu e patën miratu planin dhe programin.

Qe për shembull, ka qenë, e kanë hjekë Mark Krasniqin që s'bon me mësu. I bon do poezi jashtëzakonisht t'mira për fmi. E kanë hjekë edhe asgja nuk ka plan dhe programe para vitit 1945. Do të thotë Rilindja Kombëtare komplet... çdo gja eliminohej. E njejta gja vlen për histori, për të gjitha landë. Ne atë punë... kanë gabu i kanë miratu por me shkuarjen time ato plane nuk janë, s'i kanë zbatu. E kemi hartu programet tona dhe ka shku. Një nga puntë e mira me të cilat unë krenohem.

Pjesa e Tretë

Halim Hyseni: Ka qenë situatë e tmerrshme, tragjike. Helmimi. Ka ndodhë në vitin 1987. Unë kom ktu {shfleton librin e tij} në qoftëse... fatkeqësisht nuk qenka këtu. Osht' hjekë... qiky libër m'ka mbetë se tjerat kanë shku. Ka fillu për herë të parë vitin 1987, jo në vitin 1990 që thuhet. Ka ndodhë në Shkollën Abaz Ajeti në Gjilan. Ajo shkollë nuk di a quhet tash Abaz Ajeti, por quhet ndryshe. Mostrat, mostrat e helmimit kanë shku në Novi Sad. Se në Novi Sad ka qenë laborator i specializuar toksikologjik. Kur mrapa s'janë kthy rezultatet e hulumtimit që a ka qenë helmim a jo, që e dëshmon.

Unë natyrisht në këtë librin tim e kam vërtetue, e kam dëshmue në mënyrë të saktë se helmim ka pasë por se më në fund u vërtetu edhe Kombet e Bashkuara e pranun. Por, kishit qenë deputete?

Anita Susuri: Jo.

Halim Hyseni: Jo a?

Anita Susuri: Jo.

Halim Hyseni: Mendova me ta thanë e po ta thom ma lehtë tash. Ka qenë ni goran Vasel Nijuis suedez, ni atdhetar, ni mik i madh i shqiptarëve. Shqiptarët kanë diskutu atje kanë kontakt me njerëzit e helmum e sene. Osht' prekë shumë. Sheh asi... njani thotë, "U botu ni libër për helmimin në vitin 1986", thotë, "A mund ta gjej?" E gjen ai edhe vjen, m'gjen edhe mu. Bisedon me të. Ka bisedu me të gjithë anëtarët e grupeve. Ka marrë e ka shkru libër. Helmimi mistik. Osht' botu. E kom atë libër. M'vjen keq që s'ju pruva. Ka bisedu me kryetarët e grupeve parlamentare. M'thirri mu edhe ndërkohë u smu nga kanceri. I kom dy botime të botuara në Kosova Sot rreth tij.

Tha, "Takohemi aty". Jemi taku poshtë. Kur ndëgjova që është i sëmurë nga kanceri u preka. I thashë, "E përballon ti se ti je mësu me përballu". Tha, "E kom përballu sot". "Pse ke përballu?" "I kom taku grupet parlamentare". Kryetarët e grupeve parlamentare. "M'kanë premtu se do ta qesin çashtjen e helmimit në kuvend". Kam qenë i bindur që s'ka me dalë por nuk munda t'ja thom atij se e shkatërroja. Thashë, "Mirë paske ba shumë edhe shpresoj dhe besoj që do t'del". Nuk ka dalë asniherë. Deri ne sillemi ndaj vetëvetës dhe ndaj impakteve tona të cilat janë evidente dhe bohemi qorr që s'po i shohim, ne nuk kemi përparim.

Edhe me këtë krenohem, me këtë libër krenohem, sepse e kam ba, e përmend edhe, jo librin natyrisht, po e përmend Ismail Kadare “Ra ky mort e u pamë”, që në Kombet e Bashkuara duke udhëtuar ky e dëgjon radion edhe thotë, “Që në Kombet e Bashkuara u pranua që në Kosovë ka ndodhë helmimi i rinisë shqiptare me helmin”. A ju kujtohet kur doli ky Vuçiqi me atë flamurin e vet atë të Serbisë që u mbështoll në Kombet e Bashkuara? Natyrisht atë s’bon me ba se është mjerim. Por është dashtë me hapë, bile në Kuvendin e Kosovës çështjen e helmimit të rinisë tonë. Na kanë vdekë njerëzit. Njerëzit vuajnë edhe sot nga helmimi. Ka qenë ni tmerr i jashtëzakonshëm.

Kshtuqë edhe për këtë unë jam disi krenar që e kam shkru këtë libër. Çka do t’ju thoja më në fund. Më në fund ajo merita ma e madhe e imja osht’ shkollat shtëpi. Kom shpëtu 430 mijë nxanës edhe student të mos e përsërisin vitin shkollor. Me përsëritjen e vitit shkollor pamundësohej organizimi i mësimi në gjuhën shqipe, a e keni të qartë? Përfundonte çdo gja.

Adela Batusha: Ma shumë ma ne kallxu përvojën tane tranzicionale, domethanë qikjo prej ‘87-së deri ‘90-tën, çka u kanë qajo fazë?

Halim Hyseni: ‘87-ta shkova në ent pedagogjik. Filloj të ndroj situata, rregulli, disiplina. Shkonte mirë nuk kisha telashe të mdha. Me kolektivin me njerëzit nuk kisha telashe të mdha. Por fillun problemet me Serbinë. Ishin bisedat me Dorina Markoviçin. Atëherë ishte ministër Muhamet Bicaj. Shkum në Beograd herën e parë unë dhe Muhameti. Kur shkum në Beograd, rruga Nemanina, aty na pranoj ai Markoviçi dhe kolegu im i Entit Pedagogjik të Serbisë, Enti për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit. Si filloj biseda unë thashë, “Kom ni falënderim të jashtëzakonshëm për ju”. Ai u liru totalisht, mendun që e zgjidhen problemin.

Ky Dorina po thotë, “Faleminderit shumë, po pse po na lavdëron kaq shumë”. Thashë, “Se na keni mësu çka duhet të bajmë. E kemi të qartë rrugën edhe vizionin tonë. Tani çdo gjë është qartësuar”. Ai tha, ai atje, “Po i kemi çu”, tha, “programet në Kosovë me i shpërnda” - mos t’ja përmendi emrin ni doktor i shkencës ka qenë në ent pedagogjik, “Ia kemi çu ai i ka pranë se do t’i shpërndaj programet”. Unë natyrisht kom dalë, e kom thirrë sekretareshën. Dhe i kom thanë, “M’falni”, thashë, “se e kom ni punë”.

E kom thirrë sekretareshën, Statovci ka qenë, tani diku në Slloveni është. I kom thanë, “Thuj filani në qoftëse shpërndan dhe në qoftëse ka premtu” se unë nuk isha i bindur se ai ka premtu. Se mane mend, mos harroni, jo studimet e mija po studimet kanadeze, studimet kroate dëshmojnë se serbët kanë vendin e parë në botë me aftësinë për të gënjyer. E pranojnë edhe vet. Unë hiç mos me thanë, qe qitu, m’lejoni {shfleton librin e tij}, në qoftëse ka mundësi t’ju lexoj çka thojnë vet.

Qe po ju lexoj: “Gënjeshtra përbën interesin shtetëror serb. Ne i njohim për të lartësuar vetën dhe për të ngushëlluar të tjerët. I njohim nga vetë kënaqësia, i njohim edhe nga ligësia për t’u trimëruar, për të

fshehur turpin tonë, i njohim edhe në shenjë respekti, i njohim edhe për liri. Njesta përbën termin e patriotizmit serb dhe kjo vërteton inteligjencën tonë të lindur. I njohim në sensin krijues, në sensin e imagjinatës dhe të inovacionit. Në Serbi çdo gënjeshtër bëhet e vërtetë. Serbët falë gënjeshtres kanë mbijetuar gjatë historisë. E thotë Dobrica Terzić.

Adela Batusha: A mundeni me m'tregu veç pak për përgjegjësinë që keni pasë në qato vitet pak para se me nisë mësimi në shtëpitë shkolla? Domethanë ti je konë drejtor i entit...

Halim Hyseni: Drejtor i entit pedagogjik. Ju kom drejtu Kuvendit të Kosovës në vitet '90-të. I kom thanë që Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë të zbatojë ligjin. Të hartoj planet dhe programet dhe të hartojmë planin për regjistrimin e nxënësve në shkollat të mesme. Sepse Serbia ishte e interesuar... janë specialist për punë. Punojnë në mënyrë ekipore. Atakuan shkollën e mesme se me pamundësimin e shkollimit të mesëm binte i tërë arsimi. Se binte menihërë arsimit universitar, arsimit i lartë. Mbetej vetëm shkolla fillore. Mbeteshe argat, punëtor fizik. Ata patën marrë vendim që me mbyllë shkollat e mesme.

Unë duke kuptuar thelbin e tyre, unë i çova letër kuvendit, m'doket letrën e kom, n'qit' libër e kom. I çoj kuvendit. Kuvendi mban mbledhje me vendimin, pajtohet me kërkesat e entit pedagogjik dhe m'jep afat dy muaj ditë me i hartua planet dhe programet për fillimin e vitit shkollor '90-'91. I kemi hartuar afër 200 vet. Kurrë njëherë ma shumë Enti Pedagogjik s'ka punu. Se të hartosh plane dhe programe dy muaj ditë osht' jo punë por është punë e tmerrshme.

Por entuziasmi, dëshira shumë e madhe e punëtorëve ishte në kënaqësi, se ata kishin fitu bindje se përfundoj puna. I kemi hartu dhe kemi miratu. Osht' në televizion dikund duhet me qenë kaseta kur unë kom thanë, që me miratu plan programet. Serbët dolën, ikën, nuk u pajtuan. Unë u thashë, "Në mes të tjerave ne kemi forume, kemi shumicën, i miratojmë plan programet. E dyta", se ata ishin më pak se ne, "e dyta në plan dhe program ishte" — thashë, origjinal, qishte bile m'kanë qit' me kafe në televizion, u thashë, "Në asni kusht nuk mund të ndodhë e as që do të ndodhë që ne të mësojmë gjuhën serbeë serbët t'mos e mësojnë gjuhën shqipe".

Qat' ditë është ndalu mësimi, gjuha serbe në planet dhe programet e gjuhës shqipe. Por, pas në kohe, pas një muaj ditë dy muaj ditë Rexhep Osmani del me një shkrim në Shkëndi se osht' në interesin tonë të mësojmë gjuhën serbe. Po mësimi i gjuhës serbe osht' interes nacional i yni ka qenë edhe osht'. Osht' mirë me ditë ne nuk ka kurfar' t'keqe që e dijmë. Por ajo bohej me qëllim të asimilimit tonë dhe zhdukjes tonë. E pranosh vet, ti vet po e pranon se je nëpërkëmbë, je ma i ulët dhe i nënçmuar, i poshtëruar. Për këtë arsye isha, por ky ka qenë qëndrim i Lidhjes Demokratike. Nuk e fajësoj Rexhep Osmanin por ka qenë qëndrim i Lidhjes Demokratike me të cilën unë s'jam pajtu asniherë.

Megjithatë mos me pasë qenë Lidhja Demokratike unitetin që e ka pasë, kurgjo s'ish ba me shkollat shtëpi. Do të thotë edhe Lidhja Demokratike ka meritë të madhe sepse ka ndihmuar organizimin e

mësimi shtëpi shkolla. Por, procesi si ka filluar? Du të them ndalimi i shkollave, në qoftëse doni m'i inçizu qito dy fotografi masanej ju jepi. Ndëgjoni në Prelluzhë në vitin 1988, Prelluzha osht' në komunën e Vushtrisë, janë largua shqiptarët nga arsimi fillor. 281 shqiptar e 22 arsimtar nga shkolla fillore që nuk ka mundësi të ndodhë në bazë të konventave ndërkombëtare dhe sidomos Konventa për Diskriminimin në Arsim.

E kemi tjetër, në Gorazhdës, Gorazhdës osht' ni fshat afër Pejës ku ka ndodhë vrasja e fmive, katër fmive. Ku ka shkuar Hashim Thaçi. E kanë bo përmendore. Në përmendore shkruan ky Marko Gjuriç, "A i kanë vra terroristët", serb. S'kom vrejtje që ka shku se ne duhet të jemi njerëz se ata fmi nuk osht' dashtë të vriten. Por nuk osht' konstatu se shqiptarët i kanë vra.

Anita Susuri: Terrorist shqiptarë a po?

Halim Hyseni: Terrorist shqiptarë nuk osht' konstantu se i kanë vra. Kjo osht' qiky rasti, vet i kanë vra, vet i kanë vra. Se kta për ta mbajtë shtetin, për të fitu territor kta s'kanë kritere.

Anita Susuri: E përmendore shkrun shqiptarët që i kanë vra?

Halim Hyseni: Po. Po, po shqiptarët i kanë vra. 458 nxënës edhe 21 arsimtar janë larguar nga Gorazhdeci. Pejën këta e kanë pasë, e kanë në plan, për arsye të shumta, po arsyet kryesore është Patriarkana e Pejës që aty ndikimi i saj me qenë nën Serbi. "I kemi," në Vitomiricë, po ashtu afër Pejës. "Me 9 shtator largohen 732..." A jeni duke inçizuar?

Anita Susuri: Po, po.

Halim Hyseni: Fakte po jepi.

Anita Susuri: Po.

Halim Hyseni: Dy nxënës shqiptar me 33 mësimdhënës. Lepinje, Lepinje është ni fshat në komunën e Lipjanit. Janë përjashtuar 15 nxënës, se aty ka pak shqiptarë se ka qenë krejt serbët po shqiptarët kanë ble kanë shku aty, 15 nxënës me një mësimdhënës. Leposaviç, Leposaviç n'qytet, kanë qenë pesë nxënës e një mësimdhënës janë përjashtu dhe janë përjashtu nga Trepça në Zveçan nga shkolla të gjithë nxënësit shqiptar nga shkolla e mesme. Natyrisht që unë i kom vizitu, i kom vizitu këto. Se detyra ishte që me vizitu me pa qysh osht' situata. Ni pjesë të tyre, jo krejt, i kom vizitu. Kjo ishte përjashtimi.

E dyta, janë ndalë rrogat e të gjithë mësimdhënësve. Është formu shoqata e arsimtarëve serbë, "Sveti Sava". Me formimin e saj të gjithë pagat e arsimtarëve të përjashtuar shqiptar edhe të ndaluar për shqiptarët ju rrishin arsimtarëve serb. Një pjesë të atyre pagave barten edhe në Serbi. Unë natyrisht

me fakte, i kom n'libër ktu, e kom librin. Nuk e kom problem me vërtetë. Çka ndodhë tjetër që ka qenë me randësi?

Ka qenë organizimi i krejt kësaj pune... këtë punë e ka fillu me ni gabim, nuk dua ta mbroj por serbët janë nja tetë karakteristika që e karakterizojnë fashizmin. Unë po i përmendi veç dy, se fashistët Hitleri e ka përmend se për ni gjerman të vrarë do t'vrasim 150 armiq. Por këtë fashizëm që e ka përmend ky Serbia e ka zbatu para Hitlerit. Sepes gjatë luftave ballkanike në Krujë kapetani, unë e kam n'libër me emër, thotë, "Shkojnë", kur shkojnë në Krujë m'falni ju për këtë çka them, "Burri hyn brenda e gjen duke dhunuar serbi gruan e tij". Ky pa një pa dy e vret edhe del.

Kur vjen kapetani i mbledh krejt popullin dhe u thotë, "Për ni serb të vrarë ne do vrasim 150 shqiptarë". Fjalë të cilën e përmend Aleksandër Vuçiq, ju e dini këtë punë. "Se për ni serb të vrarë do t'i vrasim 150 musliman". Kjo është karakteristika e parë e fashizmit...

Anita Susuri: Po njejtë edhe në Masakrën e Tivarit ka qenë kjo.

Halim Hyseni: Tmerre, nejse. A dini si quhet libri (qeshë) s'osht' me rëndësi a ka ni titull bombastik po nuk osht' me rëndësi ajo. Çka desha t'ju them? Edhe ni karakteristikë. Viktimizimi. viktimizimi osht' etiketë e fashizmit. Edhe ni karakteristikë do ta them, është përçmimi, nënçmimi dhe përfshirë me urrejtje, me ngjalljen e urrejtjes. Këto janë karakteristikat e fashizmit. Prandaj, kur po e përmendi këtë periudhë të viteve të '90-ta fashizmi serb ka qenë në kulminacion ndaj shqiptarëve. Në procesin e përgjithshëm të gjuhës të organizimit të organizimit të mësimin në gjuhën shqipe dhe pengimit të tij në Kosovë, e dhanë e vërtetuar. Nëpër zyrat e policisë serbe kanë kaluar 700 mijë shqiptarë. Që janë ftuar në intervista, në biseda e kshu me radhë.

Meqenëse po vij te vitet e '90-ta me 5 qershor, me 5 korrik bahet okupimi i Kosovës. Serbia e merr. Unë atë ditë e kam botuar në Shkëndijë ni punim kundër këtij ministrit të arsimit në Kosovë që e patën prur. Unë isha ende në detyrën e drejtorit. Se shkun nja dy muj ditë e gjysë që unë edhe ma tutje e kryeja detyrën e drejtorit. Kur... këtë situatë tepër të randë unë... qe themeluar Komitetit për Arsim. Komiteti për Arsim është udhëheq nga ni person jashtëzakonisht i aftë, Fehmi Agani. Ka qenë fat i madh që ai njeri në atë kohë e ka udhëheq komitetin për arsim. Ai komitet përbahej nga strukturat e ndryshme.

Unë isha anëtarë si drejtor i entit pedagogjik. Ishte aty, ishte Rexhep Osmani. Se kryetar i Lidhjes së Arsimtarëve të Shqiptarëve. Por do t'ju them edhe për të se ka meritë edhe lidhja e arsimtarëve. Por, edhe atë unë, idenë e kom dhanë unë dhe do t'ju tregoj. Se janë faktet. Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë... po du me thanë se edhe Lidhja Demorativke. E thirra ni mbledhje unë si drejtor i Entit Pedagogjik. E luta që të mbahet mbledhja sepse gjendja që është është e pa tolerueshme dhe shumë e rrezikshme për të ardhmen e kombit tonë. U pajtum. Tri orë ka zgjatë mbledhja.

Në mbledhje ka qenë m'kujtohen disa, por sot osht' gjallë veç njo. Osht' ky i sindikatës, i sindikatës, ky që ka spitalin, si e pat emrin ky? M'kujtohet ndërkohë...

Adea Batusha: Po kush tjetër u konë n'qat' mbledhje?

Halim Hyseni: Ka qenë Pajazit Nushi, Eshref Ademaj, ky i sindikatës, Kavaja bre, Burhan Kavaja. Burhan Kavaja. Kom qenë unë, ka qenë, sa m'kujtohet, edhe ni anëtarë i kryesis, nën kryetar i kryesis së Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë. Se di s'po m'kujtohet emri tash. Po që ka qenë drejtor i bibliotekës ni kohë ma vonë. Në mbledhje e fillim dhe...

Adea Batusha: Më fal, mbledhja ku u majtë?

Halim Hyseni: Mbledhja në zyret e Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë. A e dini ajo, s'e di si quhet tash. Te Meto Bajraktari ajo lagja që osht'...

Anita Susuri: Tophane.

Halim Hyseni: Nuk e di tash si quhet po atëherë e qujshim area se qaty mblidheshim tont edhe diskutojshim çka me ba edhe quhej area e patriotëve shqiptarë. U mbajt mbledhja. Në mbledhje unë insistoja me këmbëkryqësi që kjo gjendje nuk ka mundësi të shkon më tutje kshu qysh po shkon. U çun kundër tan. Për ta e pakapshme se osht' e mundur që të zhvillohej mësimi komplet në gjuhën shqipe. Kur e pashë që po përfundon, s'ka mundësi, u thashë, "Zotëri", krejt mashkuj ishin, si zakonisht. Atëherë kemi qenë patriotë s'ka pasë femra.

Po them, "Zotëri, atëherë çdo mbledhje që përfundon pa ni vendim osht' e dështuar. Prandaj ju lutem kom ni propozim që nesër ta shkruajmë një letër, koncept letër dhe... sepse m'thanë se do të mbahet mbledhja e kryesisë së Lidhjes Demokratike në ora 13:00. Ne do t'ju dërgojmë nga ni koncept letër". Fehmi Agani kur dolëm nga mbledhja po më ndalë mu. Në të vërtetë e nala unë. "Profesor", se ka qenë profesor i imi, "profesor". "Halim", m'tha, "kjo punë shkon në dom të Millosheviçit sepse faktori ndërkombëtar nuk mund ta pranojë që ni komb i tërë të mos arsimohet". Në esencë ai kishte të drejtë.

Pa një pa dy i thashë, "More profesor, po kthehu knena, tregom drejt se unë politikë s'di, s'merrem me politikë. A kryhet puna e jonë brenda këtij viti apo jo? Unë e kam veç këtë pyetje". Besoni, ai ka qenë i skuqur në fytyrë. M'u duk që do të pëlçet gjaku nga fytyra. I skuqur dhe tha, "Jo". Atëherë i kom thanë, "O profesor po cili shqiptar ty do t'rrin me vite të tëra pa shku në mësim?" E ka kap... ka qenë jashtëzakonisht inteligjent. Inteligjenca e tij e mendje prehtësisë ka qenë e jashtëzakonshme. Ai veç m'ka thanë, "Halim a e ki materialin?" "Po unë mos me pasë material gati unë s'kisha folë". Tha, "Materialin nesër me çu qysh u morëm vesh", kryesin e lam deri në ora 11:00.

E kom çu materialin. Mu s'më ka thirrë LDK-ja. Në ni mënyrë isha pak, e kom meritë me ma ba. Se isha, nuk pajtohesha nuk pajtohesha me disa vlera. Nuk pajtoheshe sepse po ju them, e gjeni Kohën Ditore, ni shkrim që e kom bo i pari për Ibrahim Rugovën kom qenë unë mas kritikave të Rexhep Qosjes. Se kta e patën gjujtë në pazar me domate me sene. Titulli m'kujtohet si sot 'Do t'vijë koha kur të gjithë do t'japim llogari. Letër e hapur Presidentit të Kosovës Zotërit Ibrahim Rugova'.

Se ai në ni mbledhje deklaroi që na jemi në objektet tona shkollore a na nuk ishim në objekte shkollore. Deklaroi që ne nuk na ngutet a askujt nuk i ngutej ma shumë se na ngutej ne. Në qat' koncept në qato dy shtylla e mora unë, e përpunova, e shkrova. M'kujtohet që... e kom ni gru të Gjirokastrës dhe m'ka plakë ma shumë me veset e saj se kta që po i diskutoj. Ju e dini çfare janë. Kur u ktheva, letra doli. Baton Haxhiu si sot, Bajram Shatri ka qenë, ma kishin ndrru tekstin pak, e kishin zbutë. Se kom qenë i vrazhdë, ndonjëherë jom shumë i vrazhdë.

Shkova unë në Kohën Ditore thashë, "Kush i prek tekstet që i shkruaj unë?" Batoni, Baton Haxhiu po m'thotë, "Halim a je n'veti? Po njerin të cilin e rrëzon për toke nuk i mshohet shkelum". Atëherë ishte Bajrami, Bajramshahi me mu. I thashë, "Mirë, fal i koftë se n'rregull osht'". Por, Ibrahim Rugova e ka pasë ni t'mirë shumë që nuk ka qenë hakmarrës, ka qenë tolerant. Mendimin ndryshe ai e ka çmu mendimin ndryshe. Për atë unë kom respekt. Sot kom respekt shumë të madh për të, për qito karakteristika. Nejse, e kom çu unë dhe osht' mbajtë mbledhja e kryesisë.

Në mbledhjen e kryesisë që osht' mbajtë u çu ni televizion ka punua, ni Blakaj, Skender Blakaj. Thotë, "Kush osht' ai i marrë që mendon që ne të organizojmë mësim në shtëpi private. Nuk ia shoh për t'madhe se s'e ka thanë veç ai po ton thojshin, "S'ka mundësi m'u organizu".

Pjesa e Katërt

Adea Batusha: Po më intereson ma shumë qysh ka lind ideja? Prej kah ka rrjedhë që me thanë nashta me bo nëpër shpija?

Halim Hyseni: Osht' mirë me Bajramin me bisedu ju. Kemi qenë në Podujeve. U mbyllen shkollat. Qe këtu e keni materialin dhe vendimin. Shkum unë edhe Bajrami m'i vizitu. Atmosfera tepër e randë, shqetësimi shumë i madh. Unë u thashë atyne, shkollat e mesme ishin n'pytje. Thashë, "Mos keni dert se mësimi do të vazhdon shqip". Këtu ka lindë idea. Sepse unë punoja atëherë në zyre në Entin Pedagogjik ku oshtë Shoqata e Veteranëve, qaty i kem pasë zyret. Punvoja deri në ora 12:00 të natës. T'u mendu çka me ba, si ma ba?

Përneherë ngjarjet shkrepën. Po pse s'po fillojmë në mënyrë të organizimit nëpër shtëpi private? Sepse unë e dija që janë diku rreth 10,000 policë në Kosovë. E dija që numrin e kemi 12,000 paralele. Nuk ka mundësi kurfar' mënyre ta ndal mësimin kur ti don të arsimohesh. Në qato kushte, në livadh, në

livadh; në arë, në arë; në shtëpi, në shtëpi. Mu më lindi idea edhe e shkrova qishtë, qishtë. Po tani ishte problem realizimi. Ishin problem planet dhe programet që u deshke m'i shkurtu planet. Ishin gjashtë muj ditë kishin kalu. Gati kishin kalu bukur do muj pa shku në mësim.

I bona variantat. Janë katër, pesë varianta që thashë me thanë të drejtën sot i thashë grusë, thashë, "Moj gru sot s'di me folë me bo me m'pytë për variantet s'di çka me thanë"...

Anita Susuri: Bash për variantet deshtëm me t'pytë.

Halim Hyseni: Por i keni, i keni variantet. Janë varianti A, B, C, D. Por A, A1, A2, B, B1, B2, C1, C2. Qito m'kujtohen...

Adea Batusha: A i keni shkru vet?

Halim Hyseni: Vet, në emër tem u publiku. Ni presje nuk e kanë prek as presje as pikë s'kanë preke lidhur me këtë askush. Ka pasë tendenca që njerëzit me përvetësu por për atë është materiali i Lidhjes Demokratike kush don në kryesi me shku. Njani ka doktoru gati se në ngjarjet që i kom tregu une. Ka doktoru njani që ka qenë në Ministrinë e Arsimit dhe ka publiku. Ai kish gjetë edhe variantet edhe mënyrën dhe ai e kish përmend, "Po Halimi e ka hartu këtë por Lidhja Demokratike s'e ka thirrë". As nuk e di kush' është por ai i kishte mbledhë prej proces verbalit.

Anita Susuri: Po kto variantet i keni bo si propozime qysh kish mujtë me vazhdu?

Halim Hyseni: Po, po. Në qoftëse je C, C-ja do të thotë nuk të len Serbia. C-ja shkon vet në shtëpi private në Teqe, xhami, në kisha dhe kudo që është e mundshme dhe në ara.

Anita Susuri: Faktikisht C-ja ka qenë ajo...

Halim Hyseni: C-ja, C-ja ka qenë komplet. Se C-ja ka qenë kryesisht për shkolla të mesme. Se shkollat fillore i kanë lanë. Por ma vonë edhe për fakultete ka vlejte C-ja. Në mbledhje osht' zhvillu mbledhja në ora 13:00. Fehmi Agani u thotë, "Ngadal, mos u gutni se...", mu qito ma ka thanë Adem Limani i ndjerë osht', edhe ai ka vdekë. Ka qenë otorinolaringolog. Qaty qat' ditë tha, "Halim, qe dora. Materiali yt kaloj", tha, "po kanë thanë që je i çmendur", thashë, "Ndashtë, le t'thojnë çka t'dojnë s'po më intereson ajo punë" (qeshë).

Miratojnë materialin por nuk do t'bahej asgja mos të ishte Lidhja Demokratike e Kosovës. Sepse a u vendoske atëherë ajo kishte pushtetin komplet. Populli... e kishte mbështetjen e popullit kshtuqë nuk pat problem. Kjo... unë jam i idhnun në kta të LDK-së që po dojnë të fitojnë pikë për këtë punë. Kanë të drejtë që lypin pikë por mos t'krenohen me diçka që vet s'e ka ba, e ka ba dikush tjetër. Në kuvend ka qenë edhe në kuvend e kam përmend këtë punë po nuk është me rëndësi. Kshtu ka fillu.

A kanë vdekë kta tre njerëz {tregon nje foto nga libri} në mbrojtjen e shkollës shqipe? Për mu kta janë heronjë kombëtarë, heronjë të ardhmes. Nuk po tregojmë respekt për kta. E vetmja gja që kam ba që ni shkollë, qat' fshatin ku ka ndodhë në komunën e Istogut e qujnë shkollën e heronjëve diçka të ngjashme.

Anita Susuri: Vetëm emrat nëse mundesh?

Halim Hyseni: Po kta meritojnë shumë më shumë.

Anita Susuri: Emrat e tyne se nuk shihet në kamerë fotoja, nëse doni m'i përmend.

Halim Hyseni: Po. Muharrem Hysenaj, Burim Hoxhaj dhe Hasan Hysenaj.

Anita Susuri: Si ka ndodhë që janë vra kta?

Halim Hyseni: Policia i ka vra, policia i ka vra. Pse po organizoni mësim kur mësimi në gjuhën shqipe osht' i ndaluar.

Anita Susuri: Kjo ka qenë në fillim?

Halim Hyseni: Kjo ka qenë vitet e '90-ta. Në vitet e '91. Me 31 janar të vitit 1991.

Adea Batusha: Krejt n'fillim...

Halim Hyseni: Në Uqë të Istogit vriten tre prindërit dhe një plagoset.

Adea Batusha: A ka pasë qisi momente kur ka ndodhë qisi ngjarje masanena me pasë pak frikë edhe me thanë nashta ma lanë, nashta ma nalë? A ka pasë shumë rezistencë ndaj arsimit paralel?

Halim Hyseni: Rezistenca serbe ka qenë shumë e madhe. Por vendosshmëria e kombit ka qenë e jashtëzakonshme. Po ju them ni detaj. N'qit' rrugë që osht' s'e di a quhet Dobrovniku, ma parë është qujtë Dobrovniku. Ma herët ka qenë ni drejtor Tahiraj e ka pasë emrin, ka qenë drejtor në shkollën në Obiliq. Mramjet ka ora 11:00 po m'thret, nuk di si kom qëllu n'atë kohë, se zakonisht punoja deri në 12:00 në ora 12:00 në zyre. Po më thret. Thotë... mu më quajshin drejtor atëherë të gjithë. "Drejtor, Serbia e ka vnu drynin në hyrje të shkollës. Çka me ba?" I ndjeri ka vdekë, lehtë i qoftë kjo tokë.

I kom thanë, "Nesër unë vi edhe e thejmë drynin". Por ai guximtar ma i madh se unë tha, "Jo, ti s'ki nevojë fare me ardhë e me thy drynin. Në qoftëse duhej thyer dryni, drynin e thej unë". E ka thy. Kanë hy n'shkolle. Osht' trimni e jashtëzakonshme jo e tij po edhe personelit i cili ka punu me të. Vërtetë ka

qenë ni burrë i mrekullueshëm. Se kom pasë rast me të me bisedu se atëherë m'u deshte mu me bisedu, me drejtor më së shumti i zhvilloja bisedat.

Adea Batusha: A munësh edhe pak me më tregu praktikisht qysh kanë ndodhë qito takimet? A u dashtë m'u mshefë? A u dashtë m'u... qysh e keni organizu praktikisht qit' pjesë?

Halim Hyseni: Qe të tregoj. Të gjitha takimet kanë qenë legale. Unë kto shpjegimet për organizimin e mësimit i kom dhanë nëpër secilën komunë. Po ju tregoj rastin e Drenasit, Glllogoc. Shkova në Glllogoc, salla plot. Bona përpjekje me ju tregu qysh, si me radhë. Kur njani, ishim edhe ata çka ishin të komunës afër, njani po m'prek mu. "Çka ka?" Se reagoj kundër Jakup Krasniqi. Unë nuk e njihsha, as s'e dija që ka qenë i burgosur. Kishte autoritet si i burgosur, kishte autoritet të jashtëzakonshëm aty dhe fjala e tij çonte peshë.

Thotë, "Kadal", thotë, "se ktu osht' Jakup Krasniqi", "Po kush osht' bre ky?" Se unë s'disha. Tha, "Jakupi osht' i burgosur, ka qenë tetë vjet a nantë vjet në burg. Osht' liru ka ndikim këtu". Atëherë i kom thanë, ju kom drejtu drejt Jakupit. I kom thanë, "Zotëri Jakup, ne nuk kemi alternativë tjetër. Ose ta dërgojmë, ta qesim flamurin e bardhë t'ju dorëzohemi ose të fillojmë mësimin. Sepse vitin e ardhshëm nuk ka mundësi të filloj sepse t'parat, duhet t'i bëjmë dy fish", edhe tjetër ju thashë, "ata që kanë qenë në mësim që kanë ngelë e që sivjet e kanë kry klasën ma parë ose ka marrë pak diçka informacione nuk u duket mësimi interesant, atraktiv, monoton".

Me thanë të drejtën respektin e kam të jashtëzakonshëm për Jakupin edhe sot. Çfarë ka ba ai gjatë luftës është e tij, nuk përzihem. Por, ka qenë burrë shumë i mirë dhe mik i jemi i mirë edhe pas luftës. Ka thanë, "Unë isha kundër po tash jom pro". U kry puna. Po du me thanë që ndonjëherë ka pasë rezistencë. Osht' rasti tjetër, po ju them edhe ni detal t'vogël. Esef Ademaj ka qenë njëri ndër pesë mijë matematikan ma të mirë të botës, anëtarë i komisionit. M'u ka çu, ka bërtitë. Se unë në propozimin tim t'parë ishte që të gjithë duhet me fillu me përjashtim të Fakultetit të Mjekësisë. Aq disha aq edhe... se mendoja si mund ta bëjmë punën praktike.

Kur e kom thanë këtë ai ka qenë edhe trim edhe guximtar edhe njeri i mirë edhe akademik po edhe temperament shumë edhe pijke kah pak. M'ka thanë, "Kurrë nuk mbahet kjo punë. O' kanë m'u çelë të gjitha o' asno". Natyrisht e kom qetësu situatën. Kom thanë, "Profesor veç m'tregoni qysh ka me u zgjidh çashtja e njerëzve të vdekur, puna praktike në Fakultetin e Mjekësisë". M'ka thanë, "Ka mënyra të ndryshme. Kemi modele, kemi trupa. Kjo nuk është fare problem". Kur m'ka thanë ky kshtu i kom thanë, "Atëherë". se edhe m'bindi jo veç që i besova po edhe m'bindi. Thashë, "Atëherë po shkojmë edhe në Fakultetin e Mjekësisë". Se ai ka pasë të drejtë. Po ju them ju, mu m'ka shëru nxanësi i cili e ka kry fakultetin dhe shkollën e mesme të mjekësisë në shtëpi private, gjatë Covidit.

Adea Batusha: A u kanë nxanës i Prishtinës ai?

Halim Hyseni: Jo, i Gjakovës ka qenë, i Gjakovës. E kom nënvizu emrin e tij, Shpendi. E ka marrë vendin e parë në Komunën e Prishtinës sivjet, e kam nënvizu emrin. Shpend Rrustemi. Ka qenë i helmum dhe në shtëpi shkolla e ka kry fakultetin. Qitash për grip që ju thashë juve, ai ka ardhë në shtëpi, e kom përmend në këtë librin, qit' librin e fundit në fotografinë e tij me tregu që u kujdes për mu. I përmend edhe helmimet po natyrisht edhe shtëpitë shkolla. E qishtu.

Adea Batusha: A mundesh pak me na tregu për qysh janë mbajtur takimet për mbarrëvajtjen e procesit? Qysh u menaxhu qiky dhjetë vjeçar?

Halim Hyseni: Çdo vjet na e kemi majtë programin që... çdo vjet e kemi organizu i kemi vizitu shkollat. Ndëgjoni bre çka po ju them unë ju, ky shteti ynë ka deviju në shumë aspekte. Për shembull, osht' ligji për statusin e punëtorëve që kanë punu në shtëpi shkolla. Në ligj, kontrollone dhe ju kisha lut ta kontrolloni, shkrun këshilltarët pedagogjik. Unë në këtë libër e kom qujtë edhe arsimtarët edhe vetën që nuk kemi të drejtë të lypim, të kërkojmë privilegje sepse ne kem marrë paga. Merrne librin. Unë kom propozu dy çashtje që poashtu janë me randësi.

Themelimin e këshillave për financim, për vet financim. Në grup kom përcaktu vetën, Destan Halimin, sekretar i fakultetit dhe ka qenë dhe Bajram Shatrin. Osht' miratu. E kom thanë edhe n'libër që punën e kanë kry Destan Halimi dhe Bajram Shatri. Unë s'kom prekë gja se unë s'kisha kohë m'u marrë me atë punë. Prej kësaj, prej këshillit të vet financimit u themelu këshilli i financimit. Bajrami e ka shkru n'libër t'vet. E dyta, osht', libri i arsimtarëve shqiptarë. Ka bo alamet punë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shkollave shtëpi.

Adea Batusha: Takimet ku janë mbajtur zakonisht?

Halim Hyseni: Takimet janë mbajtur në Nazim Gafurr, në Arsim Voksh, në Emin Durak. Se punohej në këto shkolla. Po kem pasë ni shtëpi private, kem pasë në Medresë. Kemi shku edhe nëpër shkolla, ne i kemi vizitu. Osht' te ligji, që t'mos harroni. Kanë bo ni gabim. Kuvendi merr miratim që veç Entit Pedagogjik, këshilltarëve të Entit Pedagogjik të Kosovës mos t'ju njihet statusi i punëtorëve. Edhe pse krejt puna është e këshilltarëve pedagogjik. Unë e kom shkru këtu se për mu ka qenë me rëndësi. Se t'kërkosh ti ni privilegj për ni punë të cilën ke pasë me ba edhe për të cilën je pagu osht' për mu mercinare.

Tani mendoj ndryshe, jo mendoj ndryshe, mendoj ashtu po na kanë deskriminu. A din që unë nuk e marrë pensionin... se kom statusin e arsimtarit të shkollave shtëpi edhe pse jom autor. Këshilltarët e Entit Pedagogjik janë të diskriminuar, nuk e marrin. Unë ju kam drejtuar me ni letër tani Arbërie Nagacit. I kom thanë, i kom kërku, jo për veti po kom kërku edhe mu natyrisht që ktyne t'ju njihet ni status masi ju ka njoftë të gjithëve. Askush nuk kish mujtë të punoj as shkollë fillore, as shkollë të mesme po as fakultet mos të ishte qiky program të cilin osht' miratu dhe t'mos ishin planet dhe programet. Na çdo vjet e kemi mbajtur mbledhjen. Rexhep Osmanin e kanë shti në burg nja 50 ditë.

Adea Batusha: A kanë hi me naj takim a?

Halim Hyseni: N'takim, qe të tregoj. Jo në takim, ata e kanë marrë e kanë shti. Unë isha... më vdiq babai i bashkëshortës time në Ferizaj. Shkova i pashë i ngushëllova dhe u ktheva se e kisha caktu mbledhjen për përgaditjen e vitit shkollor '81-'82. Ka qenë në muajin gusht. Kur t'u mbajtë mbledhjen në shtëpi private është ni Gashi atje poshtë te Shkolla Emin Duraku. Kur po vijnë policia me Rexhep Osmanin, kur u futën brenda, "Rexhep Osmani, *ko ste vi* (Srb.: Kush jeni ju)?" Ka dëshmitar. Po prezentohem, "Drejtor i Entit Pedagogjik të Republikës së Kosovës, Halim Hyseni". Të tjerët u prezentuan të gjithë.

Thashë, serbisht, kur folëm me ta serbisht u habitën. Thashë, "A osht' e mundur me shtru ni pyetje Rexhepi?" "Rexhep a je lodhë edhe a të malltretuan?" Tha, "Prekë s'më kanë". "Ju lutem, a ka mundësi që Rexhep Osmani të ulet se është i lodhur?" "Po". Thashë, "Ne, që ta dini, puna jonë është legale. Sot trajtojmë punën e fillimit të vitit të ri shkollor në Kosovë. Unë e njoh mirë serbishten dhe çdo fjalë çka do ta them shqip, ju përkthej, besoni origjinal juve". M'tha, "Ju kta mund ta bëni kur të bëheni republikë, tash s'mund ta bëni". Atëherë filloj dialogu mes meje dhe tyre saqë në ni rast ai eprori i tyre tha, "Shuni, s'ka bisedë me to".

Janë dalë e kanë marrë Xhevdet Gashin edhe mu m'kanë thanë, "A po doni me u çu si patriot me polici apo po doni me ardhë vet në Sekretariat e Punëve të Brendshme?" "Na nuk kemi nevojë për patriot, na vijmë vet". Na caktun dhe kemi shku. Unë dhe Sylë Banulla ka qenë drejtor i Shkollës Emin Duraki, Zijadin Gashi. Ka qenë edhe drejtori i Arsim Vokshit edhe ai ka qenë. Kshtuqë se edhe ai tha, kur e pytën Zijadin Gashin, "Çka je ti?" Tha, "ISO". Kur e pytën Bajram Shatrin, "Çka je ti?" "ISO". Kaloj puna.

Do të thotë në përgjigjen e pyetjes tane janë zhvillu kudo që ka pasë mundësi edhe zyre, edhe në shkolla, edhe në shtëpi, edhe në teçe. Kudo ne kem punu. Asniherë në jetën time, punë ma të angazhuar se atëherë në vitet e '90-ta unë nuk kam ba. Jo vetëm që nuk kam ba po punën e kam ba n'shpi. Po ju them, me argumente që cilësia e punës edukative arsimore atëherë ka qenë 50% ma e lartë sesa osht' sot. Entuziazmi, dëshira, vullneti, angazhimi, morali, vizioni ka qenë i mahnitshëm. I mbetem borxh Lidhjes së Arsimtarëve të Shqiptarëve.

Sepse du të them edhe, ta shpjegoj edhe këtë. Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë, unë e pashë që e prisha ditën kur do t'më largohen. I kom thirrën Rexhep Osmanin, e kisha bashkëpunëtor të ngushtë edhe në Ent Pedagogjik se ishte punëtor i Entit Pedagogjik. E kom thirrë Fetah Bylykbashin, ni burrë jashtëzakonisht i mirë. E kom thirrë Fadil Rugovën dhe Nexhat Ibrahimin, profesor timin në Bozhur, Iliria u qujtë atëherë. Atëherë u qujtë Bozhur po ma vonë quhet Iliria, tash s'e di si quhet. Kem pi ka ni kafe dhe ju kom thanë, "Dëgjoni, si po shkon puna ne të gjithë do të largohemi. Po për të mujtë për të funksionuar si duhet sistemi i arsimit duhet ta formojmë ni shoqatë".

U nalën dhe po pyesin, “Po çfarë shoqate?” “Shoqatë të pavarur të arsimtarëve shqiptarë”. I thom Rexhep Osmanit... puna ime ka qenë e drejtpërdrejt. “Rexhep ke detyrë me taku Rexhep Qosjen dhe me lut që të bahet”, se doja ni person autoritativ në aspektin shkencor edhe për botën e jashtme edhe ktu. Që Rexhep Qosja m’u bo kryetar i lidhjes së arsimtarëve shqiptar. “Rexhep, shko bisedo me Rexhep Qosjen dhe le t’bahet ai kryetar”. Rexhepi ka shku dhe m’ka thanë mu... kur erdh tha, “Ai nuk po pranon po m’ka propozu mu”.

Çashtja është mes tyre, unë nuk e dija a e ka propozu a jo. Po me rëndësi që u zgjodh Rexhep Osmani. Lidhja e arsimtarëve shqiptar u formu në krejt botën. Librezat, librat... ka bo ni punë të jashtëzakonshme. Kom shumë respekt për Lidhjen e Arsimtarëve Shqiptarë që e ka ba. E ka ndihmu mbijetimin e sistemit në atë kohë bashkë me Entin Pedagogjik.

Anita Susuri: Zoti Halim, deshta me sekretariat që keni shku, si ka vazhdu? Policia ju ka bo pyetje? Ju ka malltreetu?

Halim Hyseni: Ma së pari na ka bastis në dhjetor të ‘91-tes në ora 04:00 kanë ardhë kanë bastis pesë polic. Kom nejt deri në ora 12:00 t’natës në polici. Kanë marrë materiale shumë. Ni natë përpara kom pasë takim në Gjergj Fishtë. Ju thashë arsimtarëve... se ishin të domosdoshme takimet me njerëz, se njerëzit ishin të pa informun, s’dishin çka me ba dhe u dufke takime me zhvillu sa ma shumë. U kom thanë arsimtarëve, u kom thanë, “Mos keni dert se ne me na ndalë mësimin në gjuhën shqipe nuk mujnë”. Kur më bastisën morën krejt materialin. Ni pjesë e materialeve e para që ishin emrat. Ishin emrat e drejtorëve, inspektorëve e me radhë.

Niherë më shkoj mendja që nëqoftëse e marrin atë letër shkojnë e lypin qata njerëz. Me lyp ata njerëz, kush e boni këtë punë? Halimi. Shpahun dilke, e disha. Thashë, “Ndëgjoni...” ishte ni detal tjetër që e kishin vendos kastofonin me inçizu krejt bisedën. Përniherë ajo u ndërpre. Kur u ndërpre ai qesha unë në mënyrë ironike. Tha, “Po, na i inçizojmë bisedat”. Thashë, “S’kom kurfar’ vrejtje n’këtë punë”, thashë, “kjo është detyra ju’, puna ju’ nuk përzihem”. M’pyti për Lidhjen e Arsimtarëve Shqiptarë...

Anita Susuri: Në sekretariat domethanë?

Halim Hyseni: Në sekretariat. Thashë, “Dëgjoni, unë e kuptoj çfarë ju po doni, po po u them. Ajo ka qenë ni çashtje publike. Të gjitha gazetat e mundshme e kanë thanë. Unë e di që ju e dini po edhe unë e di po s’ju thom”. Veç ni fjalë ma ka thanë, “A kupton ti ku je?” Përgjigja ime ka qenë, “Po, unë e kryj punën teme, ju kryne punën e ju’”. Qajo ka qenë fjala ma e randë. Në ora 12:00 të natës ma kanë pru deklaratën. Edhe kur ma kanë pru deklaratën me nënshkru isha lodhë shumë. Isha lodhë shumë edhe nuk mujsha me lexu asni shkronjë, krejt më dukej zi, megjull, turbullt.

Tha, “Pse s’pe nënshkrun?” “S’e nënshkruj se s’po muj me lexu kush çka ke shkru. E unë nuk nënshkruj dokumente të cilat nuk i lexoj”. S’kom qare pa e thanë. Ni polic, “Shko laj sytë”. Jom shku deri në tualet i kom la sytë, pak kom ardhë në veti. E kom lexu. S’kishte kurfar’ shtimi. Por, mes rreshtave kishte shumë gjon. Tha, “A ke vrejtje në tekst?” Thashë, “S’kom vrejtje”, “Po nënshkruje”. Thashë, “S’e nënshkruj”. “Po pse?” Thashë, “Rreshtat i keni lanë me plotësu”. M’ka thanë shumë korrekt, “Çdo rresht nënshkruje emrin ton Halim Hyseni”. Ni faqe ka qenë, ni faqe e gjysë. E kom nënshkru edhe jom shku.

Atë letrën që thashë ju, pas ni kohe thashë, “Unë kom nevojë me shku n’tualet”, tha, “Shko n’tualet t’çon polici”. Ky ndërkohë doli. Në qoftëse e keni pa ni katalog të fotografive të Enver Bylykbashit, e shihni që e kanë kap njanin për goje, shqiptarin n’gojë. Ai ka qenë, ai inspektori. Me mu ai shqiptari s’ka pasë punë. Kshtuqë kur ka dalë ai e kom kap qat’ material e kom shti... sepse mu m’thanë në mes të tjerave, “Ti ke deklarë në ni shkollë se Serbia nuk mund ta ndalon mësimin”.

Unë jom përgjigjë në pytjen e tij, “Po, jo që kom thanë me ni shkollë po në çdo shkollë që kom shku e kom thanë. Edhe tash po ju thom juve ktu, ju ktu s’mund ta ndaloni”. Në ora 12:00 unë isha... Por, kush kish qenë në shkollë që ju kishte transmetu fjalëve domethanë e kishin pasë njeriun e vet në institucionin e shkollës. Nejse...

Anita Susuri: Dhunë fizike a ka pasë qat’ natë?

Halim Hyseni: Ndaj meje s’kanë përdorë kurrë dhunë fizike. Dhunë fizike nuk kanë përdorë.

Anita Susuri: Pas orës 12:00 ju kanë liru pastaj? Pas deklaratës së nënshkrune?

Halim Hyseni: Po. Kom shku... nuk e di sa herë kom shku në biseda informative, janë shumë biseda informative që kom shku. Por, mu m’kanë paditë. Hala s’e di a me përmend a jo. M’kanë paditë shumë. Ka qenë ni gazetar i Jedinsko, Besevic. Oshtë martu me ni shqiptare të Gjakovës, ktu jeton. Zajmi, Zajmi mbiemrin e ka. Nuk e di, s’du me folë. Ai në Jedinsko pat’ shkru se Halim Hyseni ka vjedhë miliona dinar krejt paratë që ishin shpenzu për plane dhe për programe. Ata thonin që i kom marrë unë, jo planet dhe programet.

Ku kom banu te banesat te kjo shtëpia e pleqve që s’po di si quhet tash. Kur kanë ardhë kta që me m’bastis, njani tha, “Ti drejtor i Entit Pedagogjik”... po e kom pasë ni banesë dy dhomëshe të pa rregullune e kom marrë mas... që ka qenë kusht për me shku me ni kurs... se isha me qera. Ju kom thanë të gjithëve në Ent Pedagogjik, “Nga banesa me qera nuk shkoj”. Kuvendi osht’ angazhu me ma siguru ni banesë nga e cila e kanë heq ni, djalin e ni gjeneralit dhe jam vendosë unë. Qysh e kanë hjekë e tek e kanë hjekë...

Po ka qenë Nebi Gashi kryetar i parlamentit i cili e ka urdhëru Isa Mustafën, se Isa ka qenë kryetar i kuvendit. Dhe objektivisht unë Isës i kom borxh si njeri se m'ka siguru banesë. Edhe ky mos me u pasë angazhu edhe ata unë s'kisha pasë banesë. Po kisha vendosë, nuk shkoj drejtor...

Anita Susuri: Kjo u konë '80-tave, a po?

Halim Hyseni: Po, '80-tave, para ndryshimeve kushtetuese. E qishtu. Qishtu ka qenë.

Pjesa e Pestë

Adea Batusha: Këtë pjesën e mësimdhënies e para a ka pasë për shembull kundërshtim prej mësimdhënësve s'po na pëlqen qishtu ose... qysh ka funksionu qikjo komunikimi me mësimdhanës?

Halim Hyseni: Jo, kurfare. Problemi ma i madh i mësimdhënësve ka qenë çashtja ekzistenciale materiale. Po ju jemi ni shembull që e di konkret. Mësimdhënësi me autobus na patëm deklarë që me i bart mësimdhënësit pa ju kërku mjete financiare. Mësimdhanësi mu ma ka thanë, "Asgja ma rand nuk po përjetoj sesa momentin që po futem në autobus e s'po kom mundësi me ba pagesën". Se të frikësun, të dyshun... pos atyre që i kanë pranë me kohë, tjerë s'ka pasë. Arsimitarët kanë qenë në nivelin ma të lartë të mundshëm moral.

Adea Batusha: E në aspektin, për shembull, qysh u dashtë me ndrru metoda e mësimdhënies a mundesh me tregu pak këtë të klasës? Qysh ka ndrru mënyra qysh u dhanë mësim? A janë marrë metoda alternative të mësimdhanjes?

Halim Hyseni: Dëgjoni, çashtja, ju e dini përgaditja psikologjike është vendimtare në këto momente të vështira. Janë ulë n'tokë, janë ulë në shilte, janë ulë kudo që kanë mujtë. I kanë bajt librat qysh kanë mujtë. Me vëmendje të jashtëzakonshme e kanë përcjellë mësimin. Ni problem kanë dashtë me na ba që m'i organizu grupet banditeske që te shkolla t'i sulmojnë vajzat. Kem pasë rast këtë te trimat, kjo, Vranjevci, Kodra e Trimave që quhet, kem pasë rast. Mirëpo kemi angazhu njerëzit tanë që ka qenë edhe të guximshëm që kanë shku ju kanë thanë, "I prekni, i ngucni ju nxanëset atëherë do t'keni punë me ne".

Anita Susuri: Kush i ka bo kto banda?

Halim Hyseni: Po Serbia sigurisht, Serbia përmes njerëzve t'vet. Se Serbia, nuk e dini ju, m'falni për fjalën gabim i madh i imi. Po kta janë patelogjikisht janë të orientun për përfitimin e territoreve të reja.

Nuk e di nëse keni lexu para nja dymbëdhjet dite kom pasë ni shkrim Car Lazari¹, kta për pjesën veriore, osht' *Casus Belli*², shkas për me nisë luftën për jug. Se ky me gisht tregues {çon gishtin tregues lart} osht' jugu. i ka njëkë krejt shqiptarët nga Çamëria në '45-ten. Qe ku e keni, pse po flas kur kom mundësi me ju [lexu]? {shfleton librin e tij}. Qiky osht' fotografia {tregon ni foto nga libri}.

Anita Susuri: A oshtë në Mitrovicë kjo?

Halim Hyseni: Lazari në Mitrovicë.

Anita Susuri: Lazari, po.

Halim Hyseni: Qe ku thotë, 'Car Lazari nga Mitrovica e Veriut me gisht tregon jugun, tokat shqiptare të cilat Serbia,' sipas tij, "duhet t'i sundoj. Ose krimineli Napoleon Zervas nga Parga me gisht tregon veriun, tokat shqiptare të cilat Greqia tenton t'i përvetësoj'.

Adea Batusha: E për teste qysh ka funksioni? A ka pasë hiç provime formale?

Halim Hyseni: Provimet kanë qenë... a dini që na kemi pasë provimet i kemi pasë testet. Ka funksionu...

Adea Batusha: Teste përgjatë procesit mësimor.

Halim Hyseni: Testet për regjistrim në shkollë të mjekësisë i kemi majtë, i kemi zhvillu dhe i kemi zhvillu në Shkollën Arsim Vokshi në mënyrën ma të ndershme t'mundshme. Ka ardhë policia m'ka gjetë mu, Bajram Shatrin, Zijadin Gashin dhe drejtorin që ju thashë. "Kush jeni ju?" Qata që u prezantova që ju thashë ju dhe që kemi shku. Testet i kemi majtë. E dyta, vlerësimi ka qenë i arsimtarit. Nuk kemi bo teste të veçanta ne. Po nota e arsimtarit ka qenë, sipas opinionit tim jo e argumentuar po opinionimi im është. Ka qenë maksimalisht e drejtë sepse kem pasë ni vullnet të jashtëzakonshëm edhe të arsimtarit po edhe te nxanësit.

A dini çka t'ju them? Duket paradoksale për ju po mu shpirtërisht po më mungon ajo kohë, po më mungon ajo kohë. Sepse ka qenë kohë e vizioneve, vizioneve shumë të larta. Ni forcë e hatashme morale gjithë kombëtare. Diaspora ka qenë e përkushtuar jashtëzakonisht për ne. Lidhjen e Arsimtarëve të Shqiptarëve e themeluan në Maqedoni, e themeluan në Perëndim. Gjithkund ka funksionu Lidhja e Arsimtarëve të Shqiptarëve. Kshtuqë, desha t'ju them, pa u çu... e kem pa disa

¹ Car Lazari (Princi Lazar Hrebeljanović) ishte sundimtar mesjetar serb i shekullit XIV, i cili u vra në Betejën e Kosovës më 1389. Ai është shndërruar në figurë qendrore të mitologjisë kombëtare serbe dhe përdoret shpesh si simbol i sakrificës dhe i pretendimeve historike serbe mbi Kosovën.

² *Casus belli* është shprehje latine që do të thotë "shkas për luftë" dhe përdoret për të përshkruar një arsye ose justifikim zyrtar për fillimin e një lufte.

dhunë. Kjo është ni protokoll që e kem ba mas luftime, që e kom ba unë. E kom hulumtu dhe qe edukimi multi-kulturor {tregon disa libra}.

Nuk ka mundësi në shtete multi-kulturore ndarje në vija etnike. Osht' non-sens. Prandaj, kom shkru shumë për asociacionin e komunave serbe. Gjaja ma e rand që ka mund me ndodhë pas luftës ka ndodhë me hyrjen tonë në dialog me Serbinë pas vendimit jo obligues por të argumentuar juridikisht të gjykatës ndërkombëtare për drejtësi në korrik të vitit 2010. Bisedën që e ka ba kta që kanë hi... prandaj unë e kam ktu. Se s'ka shkollë s'ka shoqëri multi-kulturore pa shkollë multi-kulturore. Sot Serbia organizon edhe shëndetësinë edhe arsimin komplet në mënyrë të pavarur, që është kundër kushtetuese.

Ne heshtim. M'vjen keq. Unë s'kom heshtë i kom shkru atij, i kom shkru deri tash dhjetë artikuj në këtë temë që e kom kundërshtu. Sot heshtë edhe Serbia. Sepse, mos harroni, ni projekti i parë që Serbia, kërkush nuk e din, e përmend Garashaninë, jo. Në vitin 1836 Vuk Karaçiç, Ukë Stefani, kriptu Shqiptari e ka shkruar librin në gjuhën gjermane, "*Srbi*," e di që s'e dini serbishtën "*svi i svuda*", "Serbët të gjithë dhe gjithkund". Domethanë të gjithë kanë m'u përhap dhe gjithkund.

Ku osht' ni serb ajo osht' tokë serbe. Projekti... në Graçanicë shtëpia e kulturës e bartë emrin Rasko. Kshtuqë osht' fatkeqësia ma e madhe dhe fjala e fundit e imja është porosia për ju është që mediat, celularët e sene po kryjnë punë t'mirë po ma shumë po kryjnë punë keq. Sepse e kanë vra ndjenjën dhe nevojën për lexim. Leximi është i domosdoshëm për zhvillimin e trurit sikurse që është i domosdoshëm ushqimi për organizmin e njeriut. Dobësia ma e madhe e sistemit të arsimit edhe përpara edhe sot osht' mungesa e atdhe dashurisë. Duhet njohja e kulturës, historisë tone.

Ne mësojmë histori sllave. I kom krahasu librat, a din që librat në gjuhën serbe janë ma t'mira se librat që botohen te ne. Se atje thotë te librat serbe, thotë që shqiptarët kanë bo shumë protesta në Kongresin e Berlinit. Që nuk shkrin në tekstet, në librat e gjuhës shqipe...

Adea Batusha: Po kom qef pak me ditë për, çka menon ti që u konë trashëgimia e qasaj kohe për arsimin mas luftës? Domethanë çka i ka ra vitet '90 arsimi paralel për arsimin 2000 e te knej masnej?

Halim Hyseni: Dëgjoni, unë kam qenë në qeverinë e përkohëshme. Drejtor ka qenë, ministër ka qenë Hajrullah Koliqi. Periudha ma e ndritshme e punës ka qenë gjashtë muj ditët e para. Të faleminderit shumë. Krenar jam edhe për këtë punë. Sepse unë kom ndiku që ka shpëtu gjenerata e vitit 1998-'99 pa pasoja. Sepse isha në banesë. Në banesë ishte edhe Bajram Shatri. Se unë dhe Bajrami kemi punu shumë. Në banesë m'u fut' Flaka Surroi.

Anita Susuri: Në '98?

Halim Hyseni: Në '99-ten. U fut brenda. Osht' mike e mirë, kom bashkëpunu me të. Krejt fotografitë e shkollave, krejt i ka shkruar. Ka bo ni punë të jashtëzakonshme dhe për mu është ni atdhetare e jashtëzakonshme. Me të thanë të drejtën le të thotë kush çka të don, ky është mendimi im dhe s'ka kush ma ndalon edhe me dashtë. M'tha, "Ndëgjo, unë e pata ni takim të Kombeve të Bashkuara", ishte Peter Bakalian. Kishte ardhë nga Afrika e Jugut. Ai ka pytën Flakën, "Kush mundet me më ndihmu për arsim? Se jom i interesun ta ndihmoj Kosovën për arsim". Flaka më propozon mu.

I kish thanë, "Po". E caktojnë takimin. Të nesërmen m'doket nga ora 10:00. Unë e marr Bajram Shatrin. Bajram Shatri shkon atje na tregon qysh osht'. Dojnë me formu Komisionin për Arsim të Kombeve të Bashkuara. "Jam i interesuar që ta ndihmoj Kosovën". Për vitin e ardhshëm shkollor jo për vitin që shkoj. Thashë, "Osht' ni problem këtu. Nuk mund të fillon viti shkollor sepse viti shkollor i cili ka kalu osht' ndërpre në mars. Kemi raste që nxënësit nuk i kanë zhvillu shkronjat. Që do të thotë nuk kanë mësu sa duhet. Më shumë se ni e treta e programeve nuk osht' zhvillu. Prandaj, unë mësoj që duhet të vazhdojmë edhe nja, s'paku dy muaj ditë, që t'i kompenzojmë çashtjet ma kruciale që janë të domosdoshme për të vazhduar".

U pajtuam. Tha, "Po unë e kom ni propozim". Tha, "Kom propozim që ti me qenë kryetar i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Arsim". Ishim prezim unë, ishte prezent ni Geci ka qenë në universitet prej fakultetit dhe Januz Salihaj. Thashë, "Në qoftëse është vendimi juj' osht' n'rregull po ka edhe mundësi të tjera". "Jo, jo", tha, "kemi bisedu edhe me Flakën mendoj që kishte me qenë mirë. E pranova. Mendoj që osht' i vetmi rast ku organet e Kosovës kanë udhëheq Kombet e Bashkuara. E fillim punën dhe ai ka qenë shumë i mirë. E ka hartu deskun. Desku osht' dizajnimi i sistemit edukativo arsimor të Kosovës. Ai ka punu 90% të punës e ka bo ai po i kem ndihmu edhe na. Nejse.

Mirëpo atij i doli problemi që duhet për çështje familjare të shkoj. E lëshoj. Pas tij erdhi Steffi Schnoor³ dhe Michael Daxner⁴. E hodhën programin e diskut dhe organizuan ni program të ri të reformimit të sistemit të arsimit i cili ka qenë shkatërrimtar. Arsimin e solli në ni pozitë të pa lakmueshme. Së pari Michael Daxner na ka thanë që, "Ju jeni, ju lavdëroheni shumë se jeni dardan". Nuk e di kush ia ka thanë këta atij por e di se... Vasa Čubrilović e thotë, qe këtu e kom, e thotë, "Ne duhet ta krijojmë urrejtjen te populli serb edhe të tjerë ndaj shqiptarëve. Çështja e parë që duhet ta bëjmë është të thojmë që shqiptarët nuk kanë lidhje me ilirët".

Shihej që ai kishte jo orientime, qëndrime të cilat dashamirëse për arsim. Aty jemi grind, jemi nda. Unë s'kom bashkëpunu me ta hiç fare. Ka thanë që unë jam nacionalist, a unë s'kom lidhje me nacionalizmin. Se unë e di që njeriu, para së gjithash duhet me qenë njeri. S'e di a t'kujtohet ai gjermani që e ka themelu atë shkencën kur e thotë, e kanë pytë, "Si e ke emrin?" "Emrin", thotë, "e

³ Steffi Schnoor ishte eksperte gjermane e arsimit që punoi në Kosovë pas vitit 1999 si pjesë e UNMIK-ut, ku udhëhoqi punën për rindërtimin dhe organizimin e sistemit arsimor në fazat e para pas luftës.

⁴ Michael Daxner është sociolog dhe akademik austriak, i cili pas vitit 1999 ka udhëhequr Departamentin e Arsimit dhe Shkencës në kuadër të UNMIK-ut, duke qenë përgjegjës për rindërtimin dhe reformimin e sistemit arsimor në Kosovë.

kam njeri”. “Po si e ki mbiemrin?” “Mbiemrin e kam gjerman”. Unë shkoj me këtë, emrin e kam njeri mbiemrin e kam shqiptar. Krenohem sepse as shka, as gjerman, as amerikan, as shqiptar nuk mund të bëhet njeri s’mund të bëhesh i mirë nëse nuk je njeri, nuk ki vlerat njerëzore.

Drejtorëve që i kom majtë, i kom dikund 800 drejtor që kanë kalu në trajnime deri tash. “Drejtor mos harroni që n’rend të parë ju duhet t’jeni njeri. E dyta, duhet ta keni kopin”, kta s’e dishin çka osht’ kopi. “Duhet të keni kompetencat dhe ta keni pasionin”. Se profesionin të cilin nuk e don nuk mund të jesh i suksesshëm. Mund të jesh shumë i suksesshëm, shumë i aftë po në qoftëse të mungon pasioni kjo vjen n’tokë, rrzohet. Ajo që desha t’ju them ju, po kthehem te ‘99-shi. Ne kem gabu sepse në vitin 1991 Serbia e ka organizu, janë tubu të gjitha partitë politike. Me Vojislav Kostunica e me krejt. Kanë hartu programin për zgjidhen e problemit të Kosovës.

Për me zgjedhë problemin e Kosovës, themelimi i qendrës koordinuese për Kosovë dhe Metohi. Ju sigurisht e dini këtë punë. Kryetari i qendres koordinuese osht’ zgjedhë Nebojsa Covic. Qat’ ditë me 02 gusht të vitit 2001 kanë ba intervista mbi tre personalitete shqiptare, gazetarët serb, edhe kta e kom n’libër. E pyesin Ibrahim Rugovën, “Çka po mendoni për qëndrimin e Serbisë që me formu qendren koordinuese për Kosovë dhe Metohi?” Ibrahim thotë, “Ne me serb flasim veç për pavarësi”. Nuk e mohon themelimin e qendres koordinuese. Shkojnë e pyesin Hashim Thaçin. Hashim Thaçi thotë, “Serbët mund të hyjnë e të dalin ku të dojnë se interesohen për popullin e vet”. S’e mohon.

E pyesin Ramush Haradinën, Ramushi thotë, “Unë do t’bisedoj me faktorin ndërkombëtar”. A ka bisedu a s’ka bisedu, osht’ punë e tij. Por rezultati shihet që nuk ka bisedu. Qat’ ditë që u formu qendra koordinuese nga Beogradi ka ardhë që m’i lshu të gjithë postet që i kanë serbët në Kosovë. Sepse postet e tyne i caktojmë ne. Problemet e Kosovës kanë fillu në vitin 2000 e këndeje edhe në arsim. Kshtuqë... se di a u përgjigja si duhet a jo? Por problemet janë qito. Ndëgjoni, unë kom ni dëshmi. Qit’ [tregon një libër të tij] në 328 shkolla e kem realizu qit’ projekt, diku ka qenë ni vjet. Me UNICEF e kemi realizu. A po besoni që e kemi ndalë dhunën? Osht’ zvogëlu shkalla. Sidomos osht’ ndalë shkalla e dhunës strukturore.

Dhuna strukturore osht’ ajo dhunë ku nuk dihet ushtruesi i dhunës, që dikush po m’dhunon po s’pe di kush. Dhuna strukturore osht’ dhuna shtetërore. Kem konceptu po ashtu se jo që osht’ zvogëlu shkalla e dhunës po është përmirësu çështja e cilësisë së punës edukativo-arsimore në ato shkolla. Se janë përmirësu krejt ambientet shkollore. Kshtuqë për këtë arsye mendoj që 2000 e këndeje ka qenë shteti ka dështu. Kjo s’osht’ pyetje e juja. Për mu qitne, se unë e kom qit’ n’libra, po... a keni pyetje?

Anita Susuri: Deshta vetëm, se e kalum ni pjesë shumë të rëndësishme. Është lufta që është zhvillu edhe e di që ju, ju m’tregut faktikisht që keni qenë në atë listen e njerëzve që kanë qenë për likuidim. Qysh ka qenë prej ‘98-tes deri...

Halim Hyseni: Ka qenë me 28 mars, ka qenë dita e bajramit.

Anita Susuri: '99-ta.

Halim Hyseni: '99-ta. Atë ditë fillun prej Taukbahçes me gjujtë ajo pjesa si quhet naltë atje...

Anita Susuri: Sofalia ose Velania.

Halim Hyseni: Sofalia, nejse s'o me rëndësi s'i quhet. Jo Velania po pjesa e kundërt e Velanisë. Unë nuk flija në shpi po ndroja banesën që mos me m'zanë. Kur kanë ardhë, ka ardhë vllau im që është ktu me m'lypë. Ka qenë ni serbe kojshi, para, kojshi me mu. Bashkëshortja ime osht' motër medicinale. Si humane i ka ndihmu me ia mat tensionin e qito me radhë. Kur ka hy vllau naltë atje, s'ka qenë kërkush. Se unë dola me bashkëshorten time. Kur dola unë me bashkëshorten time, ka ardhë vllau. Ajo serbja i ka pa policinë që po vijnë. E kanë ndalë vllaun para banesës, thotë, "Ik se po lypin Alin".

Kjo osht' mesele për me qeshë me ju. Ajo emrin s'ma ka ditë si Halim po si Ali. Grusë tem shpesh herë i ka thanë Ali. Niherë gruja jem i ka thanë, "Oj Dobrillë, mos e quaj Ali se mundet dikush me të keqkuptu se mendojnë që po vjen naj Ali e une po e tradhëtoj burrin. Burri jem emrin e ka Halim jo Ali". Kjo i ka thanë, "Po vijnë policia, ik dhe fshihu poshtë me ni podrum". Vllau ka dalë poshtë dhe u mshef atje. Kanë ardhë naltë dhe kjo kur kanë ardhë naltë kjo Dobrilla i ka prit. Po du me thanë që në secilin popull ka njerëz t'mirë, ka t'kqi edhe t'mirë. Edhe te serbët nuk janë krejt t'kqi ka edhe t'mirë.

Thotë, "Ata kanë shku, kanë dalë, nuk janë këtu". Ka janë dalë te poshtë ka thanë, m'falni në shprehje, "*Pobegao nam je, majku mu*", "Ka ikë nanën atij ia lufshëm", se kishin qenë me shami. Që do të thotë se kanë qenë njerëz të Arkanit. Kanë lypë edhe më pas. Se kur u kthym na, se unë shkova për Shqipëri. Kur u kthym na tani kojshitë tregojshin qysh kanë ardhë dhe t'kanë tregu, e kshtu me radhë.

Anita Susuri: A e keni pasë vështirë me shku deri në Shqipni? A qysh ka qenë rruga?

Halim Hyseni: Unë kom shku në Bllacë. E kom ni shok, ni Shyqri Thaçi kemi qenë në normale, kemi qenë bashkë. Unë s'kisha veturë dhe gruja m'tha... i thashë unë grues në mes tjerash se valë si lumi njerëzit dalshin, ikshin. Kjo i shikonte prej dritarës, ishim në katin e tretë. Qaty e kom pa, e kom ditë që e du grujen teme shumë. M'u dhimtë shumë dhe i thashë, "Kqyre gru, të lutem, shko ti. Se unë nuk muj me dalë". Gruja m'tha, "Unë nuk shkoj pa ty", tha, "po kom ni lutje. Lype Shyqri Thaçin mos mundet me veturë me na çu deri në Bllacë e me shku për Shqipëri". Se unë miqtë i kom në shpi, edhe kom qenë te miqtë.

Kom shku te Shyqa, e kom taku Shyqen. Shyqa ka thanë, "Po Halim, po dalim". Edhe Shyqa me krejt familjen me ni, e ka pasë ni veturë t'vogël, kemi dalë deri në Bllacë. Në Bllacë kemi nejt 24 orë. Natën kanë ardhë na kanë lypë po kta i shikonin veturat, vlerat e veturave. E panin që s'o veturë e mirë nuk na

ngucnin. Kanë ardhë na kanë kqyri, pleq tek janë, s'janë lodhë shumë. S'kem pasë problem. T'nesrit kom dalë dhe kom nejt ni natë në Maqedoni. T'nesrit kom shku për Shqipëri dhe qikjo ka qenë hesapi.

Anita Susuri: E kur jeni kthy, qysh e keni gjetë vendin? Banesën?

Halim Hyseni: Banesa ka qenë e thyer. Për me tregu deri në fund, kjo serbja e ka rujtë banesën sa kanë qenë serbët. Po ia kemi kthy dyfish. Se kur erdhëm na, kjo na priti po me frikë shumë të madhe. U mor' vesh me grunë time se nuk e çelke derën, s'guxonte me çelë derën. Gruja ime lehtë, unë s'e kom problem se s'kom komplekse për kit' punë. Trokit e mëson se qysh troket ajo edhe i thotë, "Kur trokas qishtu, dije që jam unë". Ni ditë vijnë kta të KFOR edhe me lyp ata. I mshojnë derës. Për m'i ndihmu diçka materialisht, m'i çu sene qysh e kanë pasë zakon. Ajo s'ka dalë. Gruja del. Kur del gruja i mëshon kshtu, e çelë derën. I thotë, qishtu, qishtu.

Len përshtypje t'mirë te ky KFOR-i. Thotë, "Sa mirë që osht' bashkëpunimi". Ajo Dobrilla m'ka thanë, "Banesën po ju la, çelsat po ju la. Kur t'keni nevojë për para ju m'jepni". I kom thanë grujes shko thuj, "Që na nuk marrim përgjegjësi as nuk e blejmë banesën as me na falë nuk e marrim. Sepse ne në qit' situatë qysh osht' situata çfarëdo që unë bëj gjithmonë do t'del se e kemi keqpërdorë pozitën. Ne nuk e keqpërdorim pozitën. Unë nuk e blej banesën e saj". E ka ble banesën e saj shumë lirë dikush tjetër, unë s'e kom ble banesën.

Anita Susuri: Mirë, nëse doni edhe diçka për fund me shtu, nëse keni harru diçka?

Halim Hyseni: Jo s'kemi harru po unë kom folë shumë (qeshë). Diçka du me ju kallxu sekret. U fol për Lidhjen e Arsimtarëve Shqiptare. Gruja jem është e Shqipërisë, e Gjirokastrës po de facto prejardhjen e thellë e kanë nga Frashëri, mbiemrin e kanë pasë Frashëri. Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë emrin ia ka vendosë gruja ime. Rexhep Osmanit i thotë, "Rexhep të lutem, kam ni propozim", unë kisha mundësi m'i thanë Rexhepit, "Vnoja", edhe s'e kom problem. Po ajo e thotë, "Vnoja emrin Frashër se unë jam frasherjane". Ni meritë e saj është për Lidhjen e Arsimtarëve Shqiptare.

Anita Susuri: Ju faleminderit shumë edhe për kohën edhe për kontributin e jujt'.

Halim Hyseni: S'ka përse.